

RAPORT STUDIMOR

mbi

të Drejtat e Punës së Gazetarëve



RAPORT STUDIMOR

mbi

të Drejtat e Punës së Gazetarëve

Faktorët që ndikojnë në shkeljen e të drejtave të punës dhe pengesat që hasin gazetarët për t'i rifituar ato nëpërmjet gjykatës.

Maj, 2020

Ky studim u realizua në kuadër të projektit “Mbështetje për median e pavarur në Shqipëri”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit me mbështetjen financiare të Ambasadës Britanike në Tiranë dhe Institutit East West Management nëpërmjet projektit të USAID/Justice4All.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet Ambasadës Britanike në Tiranë, USAID-it apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Përgatitën:

Valbona Sulçe Kolgeci (MA) dhe Endrit Shabani (Msc, DPhil Oxon)

Autori © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Tel: +355 (0)4 223 3671

Mobile Office: 068 20 236 99

Mobile Klinika Ligjore: 069 40 757 32

Email: office@ahc.org.al

Website: www.ahc.org.al

Kutia postare: 1752

Rr. Brigada e VIII

Pallati Tekno Projekt

Shkalla 2 Apt 10 Kati 6

Tirana, Albania

PËRMBAJTJA

Akronime	5
Hyrje	7
Përmbledhje Ekzekutive	10
Gjetjet Kryesore	11
Metodologjia	16
Kapitulli 1	23
1. Situata e respektimit të të drejtave të punës së gazetarëve	23
1.1 Shkeljet e evidentuara.....	23
a. Moszbatimi i kontratave dhe/ose mungesa e kontratave	26
b. Shpërblimi financiar dhe faktorë të tjerë të lidhur me të	29
c. Respektimi i kushteve të punës	36
d. Largime të padrejta nga puna	42
e. Siguria në punë në lidhje me profesionin.....	45
1.2 Analizë krahasimore e shkeljeve të së drejtave të punës së gazetarëve	46
a. Lloji i medias	46
b. Qyteti ku ndodhet media apo gazetari.....	47
c. Rubrika dhe pozicioni në hierarkinë e medias.....	51
d. Vjetërsia në punë e gazetarëve dhe qasje të ndryshme ndaj tyre.....	54
e. Gjinia	56

Kapitulli 2	60
2.1 Mjedisi mediatik që lejon shkeljen e të drejtave të gazetarëve (tregu)	60
2.2 Pengesat për të reaguar publikisht – Pse gazetarët nuk reagojnë publikisht për shkeljen e të drejtave të tyre në punë.	71
a. Faktorët institucionalë (operatorët mediatikë)	71
b. Faktorët ekonomikë dhe socialë	74
c. Faktorët psikologjikë-kulturorë	79
2.3 Pengesat për t'i rifituar të drejtat gjyqësisht	80
2.3.a Faktorët ekonomikë dhe socialë (shoqëria)....	80
2.3.b Faktorët institucionalë (shteti)	82
2.3.c Mjedisi kulturor dhe psikologjia individuale (individi).....	89
Kapitulli 3	98
Rekomandime	98
Bibliografia e studimit	105
Instrumentet	109
Aneksi 1	109
Intervistë e thelluar	110
Pyetësorët	112
Instrument për fokus grup gazetarë të medias (print, online dhe audio-vizive)	118

AKRONIME

ISHPSHSH- Inspektorati Shtetëror i Punës
dhe Shërbimeve Shoqërore

DPT- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

RTSH- Radio Televizioni Shqiptar

VKM-Vendim i Këshillit të Ministrave

ILO-Organizata Ndërkombëtare e Punës

MOM-Monitori i Pronësisë në Media

BIRN- Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative

UGSH- Unioni I Gazetarëve Shqiptarë

KMD- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

OKB- Organizata e Kombeve të Bashkuara

HYRJE

E drejta për informim përfshin të drejtën për të mbledhur, transmetuar dhe shpërndarë lajme kudo dhe kurdo pa pengesa. Si e tillë, e drejta për informim është një faktor thelbësor për të nxitur paqen dhe progresin në botë. Ky koncept i OKB-së i vitit 1946, u ripohua 2 vjet më vonë në nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut¹. Ky përcaktim i beson medias një rol special në mënyrë që t'i japë rëndësi të drejtës për të kërkuar informacion. E fundit përfshin nevojën për një grup të veçantë garancish që kanë për qëllim të sigurojnë që gazetarët mund të përmbushin funksionin e tyre.

Gazetarët vazhdojnë të jenë aktorë qëndrorë në sferën e informacionit dhe japin kontribut parësor në realizimin e të drejtës për informim, ndaj ushtrimi i profesionit të tyre në një mjedis të lirë nga censura dhe shfrytëzimi, mbetet thelbësor për cilësinë e demokracisë në një vend. Një sondazh i vitit 2019 nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës konfirmoi se televizioni mbetet burimi i parë për lajmet e reja për shqiptarët, megjithë rritjen e mediave të reja, si gazetatat online². Një vit më parë, Unioni Europian i Transmetuesve, kishte konfirmuar të njëjtën prirje në konsumimin e lajmeve, megjithëse në pikëpamje të besueshmërisë, shqiptarët i besojnë mediat sociale dy herë më shumë se një europian mesatar³.

- 1 Asambleja e OKB-së. *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*. 302, nr.2 NewYork: OKB, 1948
- 2 Departamenti i gazetarisë, Universiteti i Tiranës. *Sondazhi, Ku informohen shqiptarët?* Tiranë
- 3 “Shqiptarët heqin dorë nga televizioni, ja ku informohen më së shumti.” *Gazeta Express*. Qershor 03, 2019.

Që prej rrëzimit të diktaturës në vitin 1991, Shqipëria është kategorizuar vazhdimisht si një vend pjesërisht i lirë në renditjen e përvitshme që bëjnë organizata të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.⁴ Sektori mediatik i vendit ka njohur zhvillime të vrullshme me kah ngjitës përsa i takon teknologjisë dhe mjeteve të punës. Shifra e punonjësve të medias ka ardhur duke u shtuar vazhdimisht, edhe me hapjen e një numri të madh mediash online, duke krijuar idenë e një tregu pluralist mediatik. Megjithatë problemet e vazhdueshme në marrëdhëniet e punës, e kanë gërryer këtë mjedis dhe efektet e para negative kanë filluar të vihen re.

Për herë të parë, në vitin 2019, kemi rënien e numrit të punonjësve të medias, nga 6200 në 5900 vetë. Arsyeja kryesore lidhet me mbylljen e disa mediave, por edhe me largimet e gazetarëve nga profesioni për shkak të pakënaqësive me kushtet e punës. Raportohen shkurtime të redaksive dhe paralajmërohen mbyllje të mediave lokale, si rezultat i procesit të dixhitalizimit^{5,6}. Gjithashtu disa studime⁷ gjatë viteve 2018-2019 kanë treguar se punësimi në sektorin e medias vazhdon të mbetet problematik, për shkak të mungesës së kontratave formale të punës, vonesës së rrogave dhe pagave të ulëta. Nga ana tjetër, edhe pse një prirje në rritje, numri i gazetarëve që i drejtohen gjykatës ose institucioneve për shkeljen e këtyre të drejtave, mbetet i vogël, krahasuar me shkallën e problemit që evidentohet nga studimet, përfshirë edhe këtë studim. Pikërisht për të eksploruar më në thellësi shkaqet e kësaj gjendjeje dhe faktorët që ndikojnë në mbajtjen e një status-quo-je të dëmshme për gazetarët në vendin e punës, por

4 Freedom House, *Freedom in the World*. Washington D.C: Freedom House, 2019.

5 Open Society Foundation, *Peizazh i medias online në Shqipëri*. Tiranë: OSFA, 2018

6 Kabashi, Gëzim. “Kosotot e dixhitalizimit mbyllin televizionet lokale”. *BIRN*, Nëntor 9, 2019

7 Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, *Tregu i punës në media*. Tiranë: IDRA, 2019

që ka implikime të rëndësishme për cilësinë e demokracisë në vend, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ndërmori këtë studim cilësor për të drejtat e punës së gazetarëve, në kuadër të një projekti mbështetur nga Qeveria Britanike dhe USAID në Tiranë.

Studimi ka si qëllim të analizojë shkaqet e shkeljes së të drejtave të punës së gazetarëve dhe rastet në nivel kombëtar. Ai është ndarë në tre kapituj. Në kapitullin e parë (seksioni 1.1), Valbona Sulçe ka parashtruar gjendjen e respektimit të të drejtave të punës, duke u nisur nga shkeljet që kanë gjetur studime të mëparshme, një pjesë e të cilave konfirmohen nga ky studim, si dhe nga gjetje të reja. Gjithashtu, në pjesën e dytë të këtij kapitulli (seksioni 1.2), Endrit Shabani ka bërë një analizë krahasimore në bazë të llojit të medias, statusit social dhe ekonomik, gjinisë, eksperiencës në punë, dhe qytetit ku punon gazetari.

Në kapitullin e dytë analizohen faktorët që frenojnë gazetarët të reagojnë publikisht apo gjyqësisht për të kërkuar respektimin e të drejtave të tyre të punës. Në këtë kapitull është analizuar mjedisi mediatik në Shqipëri, për të parë se si ai krijon kushtet për shkeljen e të drejtave të punës së punonjësve të medias. Në seksionin 2.2 të këtij kapitulli, Valbona Sulçe ka eksploruar faktorët institucional, ekonomike dhe social, dhe psikologjike-kulturore që i frenojnë gazetarët për të mbrojtur publikisht të drejtat e tyre të punës. Gjithashtu, në pjesën e fundit të kapitullit (2.3), Endrit Shabani ka analizuar në disa rrafshe pengesat që hasin gazetarët për të rifituar gjyqësisht të drejtat e tyre të punës. Për këtë qëllim ai ka eksploruar arsyet sociale (shoqëria), arsyet institucionale (shteti) si dhe konteksti kulturor e psikologjik (individi) që ndikojnë në sjelljen e gazetarëve në këtë drejtim.

Në kapitullin e tretë analizohen rekomandimet për ndërhyrjet e nevojshme për të përmirësuar pozitën e gazetarëve, dhe për të garantuar e të drejtat e tyre të punës. Këto rekomandime janë ndarë në ndërhyrje politike, ligjore dhe institucionale.

Përmbledhje Ekzekutive

Siç u tha edhe më sipër, ky studim ka synuar të evidentojnë jo vetëm shkeljet e të drejtave të punës që iu bëhen gazetarëve në redaksitë e mediave ku punojnë, por arsyet përse ata nuk reagojnë për t'i mbrojtur këto të drejta. Për këtë arsye është bërë si fillim një analizë e shkeljeve në varësi të kategorive të ndryshme, për të parë se si faktorë të ndryshëm mund të ndikojnë në përmirësimin apo përkeqësimin e kushteve të punës. Këtu janë evidentuar diferenca në kushtet e punës në bazë të llojit të medias, qytetit ku vepron gazetari, rubrika dhe pozicioni në hierarkinë e medias, moshë e gazetarit dhe vjetërsia në punë, dhe së fundmi gjinia e gazetarit.

Së dyti, janë analizuar faktorët që pengojnë gazetarët të reagojnë publikisht për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave që atyre iu garantohen me ligj. Këtu janë identifikuar faktorët institucionalë, faktorët socio-ekonomik dhe faktorët kulturorë dhe psikologjikë, të cilët krijojnë një mjedis pengues për gazetarin që të reagojë publikisht në mbrojtje të të drejtave të tyre të punës.

Së treti, janë analizuar pengesat që hasin gazetarët për t'i rifituar të drejtat e tyre gjyqësisht. Këto janë ndarë në pengesa që vijnë nga faktorët socio-ekonomik, ku fokusi është tek mënyra se si funksionon shoqëria; pengesa që vijnë nga faktorët institucionalë, ku fokusi është tek mënyra se si veprojnë institucionet publike; dhe pengesa që vijnë nga kultura e punës, ku fokusi është tek ndërveprimi i individit me mjedisin e punës, brendësimi i disa normave shoqërore si dhe besimi i brendshëm apo perceptimi për veprime të caktuara.

Në kapitullin e fundit janë rekomanduar disa ndërhyrje politike dhe ligjore për të krijuar një mjedis mediatik ku gazetari të jetë i lirë të ushtrojë profesionin e tij, duke gëzuar të drejtat që i garantohen me ligj dhe në rastet kur këto të drejta i shkelen, gazetari të ketë mekanizmat e nevojshëm për t'i rivendosur ato në vend.

Gjetjet Kryesore

Në këtë nënseksion po rendisim në mënyrë të përmbledhur gjetjet kryesore të këtij studimi, ndërkohë një shpjegim i detajuar i këtyre gjetjeve dhe burimet e të dhënave që janë përdorur gjenden në sektorët e mëposhtëm të studimit.

Si variojnë shkeljet e të drejtave të punës në bazë të gjinisë, moshës apo medias

- Nga studimi është vënë re se gazetarët e rretheve të tjera, punojnë shpesh në kushte më të vështira se gazetarët e Tiranës. Siguria e tyre në punë dhe paga, është më e ulët krahasuar me kolegët e tyre në kryeqytet.
- Gazetarët e portaleve raportohet më shpesh që të punojnë në kushte informaliteti (pa kontrata pune), dhe anonimiteti. Kjo e fundit nuk i lejon që të mbrojnë të drejtën e tyre të autorit, por as edhe që të krijojnë një profil vetjak profesional, duke u bërë pjesë e barabartë e komunitetit të gazetarëve profesionistë.
- Gazetarët e terrenit raportojnë se ndihen të pambrojtur nga kërcënimet fizike apo nga paditë gjyqësore që vijnë nga palët e cënuara prej punës së tyre. Disa prej tyre raportojnë se iu duhet të gjejnë forma alternative mbrojtje, pasi as media dhe as institucionet shtetërore nuk iu ofrojnë mbrojtje apo përkrahje.
- Më shumë gazetarët e rinj, se ata me përvojë, raportojnë që punëdhënësi iu drejtohet në mënyrë fyese. Ata gjithashtu ndihen të pambështetur nga kolegët, nëse kanë një konflikt me punëdhënësin. Për pasojë, janë më pak të prirur për të mbrojtur të drejtat e tyre duke reaguar publikisht apo duke paditur punëdhënësin në gjykatë.
- Gazetarët raportojnë për ngacmime seksuale në mjediset e punës, më së shumti ndaj grave dhe vajzave. Gazetarët

gjithashtu ankohen për mos respektimin e lejes së lindjes, çka i ndikon zgjedhjet e tyre për jetën. Megjithëse mbi 80% e tyre shprehen se punojnë mbi 40 orë në javë, ato ndihen se janë më keq ekonomikisht se kolegët e tyre burra.

Arsyet kryesore që lejojnë shkeljen e të drejtave të punës së gazetarëve:

- Sektori i medias karakterizohet nga një shkallë e lartë përqëndrimi të pronësisë dhe shumë gazetarë ndihen se tregu nuk iu ofron alternativa më të mira punësimi.
- Modeli i biznesit mediatik është i mbështetur në burime alternative dhe pjesa më e madhe e mediave nuk do mund të vetëfinancoheshin plotësisht nga reklamat. Për pasojë, interesat e punëdhënësve shpesh janë të ndërlidhura me qeverinë. Në këtë marrëdhënie midis pronarëve të medias dhe qeverisë, gazetarët janë në një pozitë të dobët negociuese, çka i bën ata të pranojnë kushte të papërshtatshme pune.
- Marrëdhënia e medias me qeverinë, por edhe fuqia e tyre kërcënuese dobëson punën e inspektorateve shtetërore, të cilët nuk arrijnë të garantojnë zbatimin e ligjit në redaksitë e mediave. Për pasojë, gazetarët ndihen të pambrojtur nga shteti.
- Mungesa e sindikatave të gazetarëve brenda enteve mediatike dhe indiferenca e institucioneve publike ndaj propozimeve të shoqatave të gazetarëve për të drejtat e punës, i ka lënë gazetarët të pambrojtur përballë abuzimit me të drejtat e tyre të punës.
- Raportohet se shumë media organizohen në një hierarki piramidale, ku rekrutimi bëhet direkt ose nën mbikqyrjen e pronarit të medias, duke iu lënë pak rol departamenteve të burimeve njerëzore. Në këto raste, marrëdhënia e punës më shumë se me institucionin është me individin dhe karriera

profesionale e gazetarëve shpesh mbetet/është në varësi të preferencave, dhe (në disa raste) të tekave të pronarëve.

Çfarë i pengon gazetarët që të mbrojnë publikisht të drejtat e tyre?

- Solidariteti mes gazetarëve është shumë i ulët. Shpesh gazetarët janë të përçarë në bazë të mediave ku punojnë, rubrikës që mbulojnë, pozicionit në hierarki, statusit ekonomik, gjinisë, moshës dhe preferencave politike. Për pasojë, shumë gazetarë nuk reagojnë publikisht, pasi druhen se nuk do të gjejnë mbështetje nga kolegët.
- Mungesa e solidaritetit kontribuon në mungesën e organizimit brenda redaksive, apo më gjerë (në nivel qyteti apo nivel kombëtar). Për pasojë, shumë gazetarë nuk kanë mekanizma përmes të cilave të mund të ngrenë zërin dhe të mbrojnë të drejtat e tyre.
- Mungesa e një kulture sindikale dhe historiku i shoqatave të gazetarëve, i bën shumë gazetarë që të kenë mungesë besimi tek këto organizime. Për pasojë, ka një ngurrim të gazetarëve për të bashkëpunuar me këto shoqata në denoncimin e pronarëve të medias që shkelin të drejtat e punës.
- Shumë gazetarë nuk e njohin mirë legjislacionin e punës, dhe për pasojë nuk janë në dijeni për tërësinë e shkeljeve ligjore që iu ndodhin atyre në mjedisin e punës.
- Mungesa e informacionit shkon krah për krah me kulturën e tolerimit të shkeljeve dhe pranimit të tyre si pjesë normale e punës.
- Frika nga hakmarrja e pronarit të medias, që lidhet me humbjen e vendit të punës, si dhe pengesa për të marrë pjesë në organizime sindikale brenda redaksisë, ndikojnë në mosreagimin publik të gazetarëve për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Çfarë i pengon gazetarët që të kërkojnë rivendosjen e të drejtat e tyre gjyqësor?

Faktorët ekonomikë dhe socialë (shoqëria)

- Pasiguria ekonomike dhe mungesa e alternativave më të mira në treg, e vendosin gazetarin në një pozicion shumë të dobët negociues përballë pronarit të medias. Për pasojë, shumë gazetarë preferojnë më mirë një punë ku iu shkelen të drejtat, sesa të rifitojnë të drejtat e tyre përmes gjykatës, por pastaj të përballen me papunësinë.
- Gazetarët besojnë se pronarët e medias koordinohen me njëri-tjetrin, duke i bërë ata që të ngurrojnë për të nisur një konflikt gjyqësor me punëdhënësin, pasi shqetësohen për perspektivën e karrierës së tyre mediatike.
- Gazetarëve iu mungon solidariteti me njëri tjetrin për të paditur bashkarisht punëdhënësin, çka do ulte kostot sociale për secilin prej tyre, dhe do rriste mundësitë për të fituar.

Faktorët institucionalë (shteti)

- Koha mesatare e një procesi gjyqësor vlerësohet shumë e gjatë nga gazetarët dhe shumë prej tyre e kanë të vështirë nga pikëpamja financiare që të presin kaq shumë që të marrin dëmshpërblimin e kërkuar.
- Kostoja e gjyqit konsiderohet tepër e lartë për ata punonjës të medias që kanë rroga minimale. Në këto raste, përveçse gjyqi është shumë i shtrenjtë për t'u përballuar, edhe shpërblimi i prituri është aq i vogël, sa shpesh nuk i justifikon shpenzimet gjyqësore.
- Shpesh mungon dokumentacioni që provon shkeljet e punëdhënësit. Shumë gazetarë punojnë pa kontratë pune ose

me kontrata fiktive, ndërsa raportet e inspektorateve nuk e pasqyrojnë saktësisht situatën e shkeljeve. Për pasojë, gazetarët hezitojnë të shkojnë në gjykatë, edhe pse kontrata e punës nuk është e vetmja provë që vërteton marrëdhënien e punës apo shkeljet e kryera nga punëdhënësi.

Faktorët kulturorë dhe psikologjikë (individi)

- Shumë gazetarë kanë pak informacion për mundësitë dhe mënyrat e rivendosjes së të drejtave të tyre përmes rrugës gjyqësore. Për këtë arsye, ata shpesh ngurrojnë t'u drejtohen gjykatave, por gjejnë rrugë alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me punëdhënësin.
- Marrëdhënia sociale me punëdhënësin dhe stigma e gjyqit, bën shumë gazetarë të rinj të ngurrojnë për ta paditur atë, pasi e perceptojnë si “tradhëti” apo “mosmirënjohje”.
- Shumë gazetarë kanë brendësuar një hierarki në punë, ku ata marrin një pozicion inferior ndaj punëdhënësit, duke toleruar shkeljen e të drejtave të punës. Ky tolerim shpesh vjen edhe prej pranimit të abuzimit si një pjesë normale të punës.
- Planet apo dëshira për emigrim, i frenojnë shumë gazetarë që të padisin punëdhënësin, pasi mendojnë se nuk do mundën ta ndjekin dot fizikisht procesin gjyqësor, por edhe sepse e shohin *status quo*-në si diçka të përkohshme.
- Pjesa më e madhe e gazetarëve nuk kanë besim tek gjykata. Shumë prej tyre besojnë se pronari i medias mund të ndikojë në vendimin e gjykatës. Ky perceptim është shumë i përhapur, megjithëse në shumë raste kanë qenë gazetarët ata që kanë fituar gjyqet ndaj punëdhënësve. Në këto kushte, perceptimi vepron si profeci vetëpërbushëse, duke i dekurajuar gazetarët që t'i drejtohen gjykatës.

Metodologjia

Të dhënat e këtij studimi janë gjeneruar përmes miksimit të metodave kërkimore. Për këtë qëllim është kaluar në disa faza, nga hartimi i studimit tek mbledhja dhe analiza e të dhënave.

Qëllimi i këtij studimi ka qënë t'i japë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- Deri në çfarë shkalle respektohen të drejtat e punës së gazetarëve në Shqipëri?
- Si reagojnë gazetarët kur të drejtat e tyre shkelen nga punëdhënësit?
- Çfarë pengesash hasin gazetarët për të denoncuar publikisht shkeljet e të drejtave të tyre të punës?
- Çfarë pengesash hasin gazetarët për të rifituar gjyqësisht të drejtat e tyre të punës?
- Si mund të krijohen kushtet që të garantohet respektimi i të drejtave të punës së gazetarëve në Shqipëri?

Kampioni, kampionimi dhe akses

Në mënyrë që t'i përgjigjeshim pyetjeve të mësipërme, studimi është bazuar në të dhënat e mbledhura nga analizimi i dokumenteve dhe intervistimi i personave të informuar. Kampionimi i dokumenteve u bë duke analizuar studimet e mëparshme në këtë fushë, por edhe duke përdorur njohurinë e ekspertëve të përfshirë në këtë studim.

Përzgjedhja e personave të përfshirë në studim u krye përmes një strategjie kampionimi. Në mënyrë që të dhënat të ishin sa më përfaqësuese dhe sa më të sigurta, kampioni u ndërtua duke marrë për bazë variabla si: vendbanimi, gjinia, mosha, lloji i medias, dhe koha e kaluar në qytetin përkatës. Në total u përfshin në këtë studim 70 persona nga 10 qytetet më të mëdha të Shqipërisë.

Në fazën e parë të studimit, u zhvilluan 19 intervista të thelluara ballë-për-ballë, dhe dy fokus grupe, ku morën pjesë 17 gazetarë. Ndërsa në fazën e dytë, u anketuan 34 gazetarë në 10 qytete të Shqipërisë. Profesioneet e personave të përfshirë në këtë studim ishin gazetarë, pronarë mediash, përfaqësues të shoqërisë civile, avokatë, inspektorë shtetërorë dhe punonjës të burimeve njerëzore. Përsa i përket gazetarëve, u synua që ata t'i përkisnin mediave të ndryshme, si televizione (kombëtare dhe lokale), private dhe shtetërore, radio, gazeta dhe portale online.

Shpërndarja e intervistave u synua të bëhej në mënyrë sa më të barabartë, por duke marrë parasysh edhe faktorë si popullata totale e kategorisë (për shembull. numri i gazetarëve të portaleve) apo vështirësia për t'u aksesuar. Megjithatë, Tirana, për shkak të rëndësisë ekonomike dhe politike, por edhe për shkak të përqendrimit të madh të medias, pati më shumë intervista se qytetet e tjera.

Përzgjedhja e të intervistuarve u bë përmes bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm, të cilët nominuan rreth 120 vetë, prej të cilëve studiuesit përzgjodhën 60, të cilët u kontaktuan për intervistë. Duke ndjekur teknikën e topit të borës, pas çdo interviste të thelluar, i intervistuari u ftua të nominonte një person tjetër që kishte dijeni për çështjet e trajtuara në studim. Nga kjo teknikë u nominuan 15 vetë, prej të cilëve arritën të intervistohen 10 vetë. Në përfundim të studimit, pati vetëm 7 refuzime në total, çka konsiderohet një numër i vogël. Në këto raste kur personi i kontaktuar refuzonte apo ishte e pamundur për të zhvilluar intervistën, ai/ajo u zëvendësua me një person tjetër brenda kategorisë dhe qytetit përkatës.

Mbas përfundimit të intervistave gjysëm të strukturuar, ashtu siç do të shpjegohet edhe në seksionin e mëposhtëm, u zhvillua një pyetësor me gazetarët e mediave lokale. Ky pyetësor u administrua nga gazetarja Anila Hoxha, dhe u plotësua nga 34 gazetarë në 10 njësi administrative të Shqipërisë (prej 61 gjithsej). Përsa i përket

gjinisë, 55% e të anketuarve ishin gra dhe vajza. Ndërsa përsa i përket moshës pjesa më e madhe e gazetarëve ishin të rinj: 32% i përkisnin grupmoshës 31 deri në 40 vjeç, ndërsa 21% i përkisnin grupmoshës 26 deri në 30 vjeç. Përsa i përket shkollimit, 76% e gazetarëve të intervistuar kanë mbaruar shkollën e lartë, 29% e të cilëve kanë kryer edhe studimet pasuniversitare. Përsa i përket vjetërsisë në punë, 45% e gazetarëve të anketuar deklarojnë se kanë më shumë se 10 vite eksperiencë pune, ndërsa 28% e tyre deklarojnë se kanë më pak se 5 vite.

Karakteristikat e kampionit të studimit							
Gjinia		Grupmosha		Shkollimi		Vjetërsia në punë	
Burra	45%	31-40	37%	Studime pasuniversitare	29%	Më pak se 5 vjet	28%
Gra	55%	26-30	24%	Shkollë e lartë	47%	5 deri në 10 vjet	26%
				I mesëm	9%	Mbi 10 vjet	45%

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Siç u diskutua edhe më sipër, mbledhja e të dhënave kaloi në disa faza, që nga hartimi i instrumenteve, në pilotimin e tyre deri në zhvillimin e intervistave.

Në fazën e parë u analizua legjislacioni përkatës dhe dokumentet e identifikuara nga studimet e mëparshme dhe nga ekspertët e

përfshirë në studim. Më pas u hartuan tre instrumente për mbledhjen e të dhënave: një pyetësor për intervistat e thelluara, një guidë për intervistat në grup (fokus grupe), si dhe një pyetësor i strukturuar për një anketë në terren.

Në fazën e dytë, instrumentet u diskutuan me ekspertë të tjerë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, komentet e të cilëve ndihmuan në përmirësimin e tyre. Më pas, instrumentet u pilotuan me dy gazetarë bashkëpunëtorë të studimit, nga ku u evidentua nevoja për të thjeshtëzuar dhe përshtatur gjuhën e përdorur, si dhe për të sqaruar më mirë disa nga pyetjet.

Në fazën e tretë, u zhvilluan intervistat në terren. Intervistat gjysmë të strukturuaruara ballë përballë dhe intervistat në grup u realizuan përgjatë muajve dhjetor 2019 dhe janar 2020. Ndërsa anketat me gazetarët, u zhvilluan tre javët e para të muajit janar 2020.

Pas përfundimit të intervistave të thelluara, dhe intervistave në grup, të dhënat u koduan përmes programit NVivo, dhe u kondesuan në një listë me kategori të kufizuara. Më pas këto kategori u përdorën për të gjeneruar pyetjet e mbyllura të anketës së përdorur me gazetarët në të gjithë Shqipërinë.

Anketa u programua në një formë dixhitale dhe u administrua përmes një tablete të lidhur me serverin qendror, çka lejonte raportimin e intervistës në kohë reale, duke regjistruar kohën e fillimit dhe mbarimit të intervistës, si dhe vendndodhjen. Intervistuesja udhëtoi nga Tirana për të takuar gazetarët e anketuar, dhe i zhvilloi anketat ballë për ballë, në mjedise të përshtatshme për gazetarin, në mënyrë që ai/ajo të mos ndërpritej gjatë intervistës, apo të shqetësohej për ruajtjen e privatësisë dhe anonimatit. Mesatarisht një anketë u plotësua në 16 minuta.

Të dhënat statistikore të mbledhura përmes anketës u përpunuan në programin SPSS, për të bërë analiza të thelluara statisikore si

univariate dhe bivariate. Të dhënat e pyetësorit që konfirmonin gjetjet e intervistave të thelluara dhe intervistave në grup, u përdorën për të dalë në përfundimet e studimit.

Gjithashtu, u analizuan korelacione në bazë të të dhënave demografike të respondentëve, si dhe përgjigjeve të caktuara. Siç shihet edhe më poshtë, në seksionin 1.2, këto korrelacione krijuan mundësinë e një analize më të thelluar duke bërë krahasimin e përgjigjeve të dhëna nga respondentët.

Vlefshmëria e të dhënave

Për të siguruar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e gjetjeve të këtij studimi janë përdorur metodat e triangulimit dhe *feedback validation*.

Së pari, siç u shpjegua edhe më sipër, në këtë studim është përdorur triangulimi metodologjik, çka na ka dhënë mundësi që të konfirmojmë gjetjet e studimit përmes metodave të ndryshme kërkimore.

Së dyti, për të siguruar një përfaqësim sa më të mirë të gjetjeve, është bërë kujdes në planifikimin e kampionit të studimit, duke synuar që të garantoni një triangulim të burimeve. Për këtë qëllim, jemi siguruar që të marrim parasysh gjininë, llojin e medias, moshën, vjetërsinë në punë, dhe eksperiencat profesionale të pjesëmarrësve në studim.

Së treti, për të siguruar një vlefshmëri të rezultateve të nxjerra nga anketa, është synuar që të sigurohet integriteti i brendshëm i pyetësorit. Për këtë qëllim, në pyetësor janë integruar pyetje verifikuese, të cilat kishin të njëjtën përmbajtje, por ishin artikuluar në formë të ndryshme. Pas analizave statistikore përgjigjet e dhëna nga këto pyetje kanë rezultuar në një korrelacion të përgjithshëm Pearson $r = 0.85$. Gjithashtu, u bë kujdes në renditjen e pyetjeve, por edhe në hartimin e tyre, sidomos në përdorimin e shkallës Likert, ku pyetjet u alternuan midis pohimeve dhe mohimeve, por edhe duke e konvertuar shkallën e pohimit. Për shembull, në listën e parë të pyetjeve opsioni

“plotësisht e dakord/gjithmonë e vërtetë” është në të majtë tek numri 1 dhe 2, ndërsa në listën e dytë “plotësisht dakord” është në të djathtë të pyetësit, tek numri 4 dhe 5.

Së katërti, kemi përdorur *feedback validation*, çka konsiston në vlerësimin paraprak që aktorët e përfshirë në studim, por edhe njohës të tjerë të fushës i bëjnë gjetjeve të studimit. Për këtë qëllim, në 12 Shkurt 2020, tek libreria Tirana Times, u zhvillua një tryezë me aktorë të përfshirë në studim, por edhe personalitete të medias, të cilëve iu paraqitën gjetjet paraprake. Komentet e pjesëmarrësve krijuan mundësinë të konfirmonim saktësinë e disa gjetjeve, por edhe të përmirësonim disa aspekte të rëndësishme të studimit.

Së fundmi, drafti përfundimtar u analizua me hollësi nga një ekspert i të drejtës kushtetuese, i cili përgatiti një peer-review, për të gjitha aspektet ligjore të studimit. Kjo analizë ndihmoi në përmirësimin përfundimtar të studimit, duke rritur besueshmërinë e gjetjeve dhe për pasojë, mundësinë e tyre për të përgjithësuar situatën e respektimit të drejtave të punës së gazetarëve në Shqipëri.

Reflektime etike

Gjatë të gjithë fazave të studimit, studiuesit janë udhëhequr nga përgjegjësia ndaj pjesëmarrësve në studim, dhe detyrimi për të mos dëmtuar në asnjë formë, asnjë prej subjekteve të përfshira drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë në të.

Në këtë drejtim, jemi siguruar që të gjithë pjesëmarrësit në studim të jenë plotësisht të informuar për qëllimin e studimit dhe të marrin pjesë vullnetarisht në të. Prandaj jemi kujdesur që asnjë prej personave të ftuar për të marrë pjesë të mos nominohet nga drejtuesit e medias, apo një person tjetër që është në pozitë autoriteti ndaj tyre.

Gjithashtu, jemi kujdesur që tabela me listën e të intervistuarve të kodohet dhe anonimizohet. Gjatë intervistave të thelluara është

përdorur një regjistruer audio, duke marrë lejen paraprake të të intervistuarit. Në një rast, i intervistuari refuzoi të regjistrohej, kështu që studiuesi mbajti shënime gjatë intervistës. Në një rast tjetër, intervistuesi e ndërpreu vetë regjistrimin, pasi e intervistuar po ndante informacione personale sensitive. Në të gjithë rastet e tjera, audiot janë transkriptuar nga vetë intervistuesi, pa u ndarë me studiuesin tjetër, apo me palët e treta.

Për të siguruar që pjesëmarrësit në studim nuk identifikohen nga citatat e tyre, janë dhënë vetëm të dhënat e domosdoshme për personin e cituar, Për shembull. “gazetar media audiovizive”, dhe jo të dhëna të tjera, Për shembull. “Gazetar i televizionit X”. Gjithashtu, në disa raste gjinia e personave të cituar është ndryshuar, pikërisht për ta bërë më të vështirë identifikimin e tyre.

Një kujdes i veçantë është bërë edhe që përmes citateve të mos dëmtohen palë të treta që janë përmendur në studim. Për këtë arsye, në citatat e vendosura, janë fshirë të gjitha referencat e emrave, logove, apo referenca të tjera që lejojnë identifikimin e një subjekti të caktuar, i cili mund të ndihet i cënuar nga përmbajtja e komentit të cituar.

KAPITULLI 1

1. Situata e respektimit të të drejtave të punës së gazetarëve

Tranzicioni politik në Shqipëri, është reflektuar edhe në funksionimin dhe organizimin e medias. Në fillim të viteve '90 media u përqëndrua tek shtypi i ditës, i cili përbëhej nga një numër i madh gazetash që shiteshin në treg. Në fillim të viteve 2000 u hapën televizionet e para private, të cilat krijuan një treg të ri, ku media financohej nga reklamat ose nga burime alternative, por jo direkt nga shikuesit, siç ndodhte me gazetatat. Ky treg i ri u shoqërua edhe me problematika të reja në marrëdhëniet e punës mes gazetarëve dhe pronarëve të medias, çka e bënte të nevojshme formalizimin e kësaj marrëdhënieje.

1.1 Shkeljet e evidentuara

Në vitet e fundit, disa studime kanë evidentuar probleme të shumta përsa i përket respektimit të drejtave të punës së gazetarëve⁸, si përshembull:

- Mungesa e kontratave të punës, apo abuzimi me kohën e provës, duke mos e paguar, apo duke tejkaluar afatin e parashikuar në ligj⁹.
- Problemet me pagat: si vonesa e pagesave apo pagesat e parregullta (pagesa jashtë sistemit bankar, mospagimi

8 Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, *Panorama e medias në Shqipëri*. Tiranë: IDRA, 2019

9 Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore dhe Citizens Channel, *Duke synuar kushte të drejta pune - Shqyrtim i të ardhmes së gazetarëve të rinj dhe atyre të ardhshëm*. Tiranë: Citizens Channel, 2019

i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mos pagimi i punës jashtë orarit apo gjatë natës, dhe mbajtja e pagës si ndëshkim).

- Mosrespektimi i kushteve të punës, si privimi nga pushimet e paguara, dhunimi verbal në ambientet e punës, dhe diskriminimi në bazë të gjinisë apo bindjeve politike.
- Mungesa e sigurisë në ushtrimin e detyrës.
- Largime të padrejta nga puna.¹⁰

Këto shkelje janë rikonfirmuar edhe nga ky studim, ku janë grupuar në kategoritë e mëposhtme:

- a. Mosformalizimi i marrëdhënieve të punës ose/dhe moszbatimi i kontratave
- b. Shpërblimi financiar dhe faktorë të tjerë që lidhen me të
- c. Respektimi i kushteve të punës
- d. Largime të padrejta nga puna
- e. Siguria në punë për shkak të kërcënimeve për shkak të detyrës

Sipas ISHPSHSH, në vitin 2019 janë kryer inspektime në rang vendi në 47 subjekte mediatike private e shtetërore me 472 punonjës të evidentuar ose mesatarisht 10 punëmarrës për subjekt. Nga ky inspektim, kanë rezultuar vetëm 2% e punonjësve pa kontratë¹¹. Por studimet flasin për një shifër 15 herë më të lartë¹². Problemet kryesore

10 Skicimi i statusit të gazetarëve dhe situatë e shoqatave të gazetarëve dhe organizatave të medias, Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë, 2018

11 Shkresë përgjigje Nr 249/1 drejtuar Komitetit Shqiptar të Helsinkit, datë 10.02.2020, nga Arben Seferi Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

12 Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, *Tregu i punës në media*. Tiranë: IDRA, 2019

kanë rezultuar: puna jashtë orarit, mënyrën e pagesës, kohëzgjatjen e pushimeve vjetore, mungesa e kushteve higjieno-sanitare dhe mbrojtja kundër zjarrit, për të cilat janë lënë detyrat përkatëse. Për këto 47 inspektime, janë marrë 1 masë ndëshkuese “pezullim” dhe 3 masa “paralajmërim”.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmblëdhur inspektimet e kryera gjatë vitit 2019 sipas degëve rajonale:

Tabela 1. Inspektimet gjatë vitit 2019
Burimi: ISHPSH, 2020

Degët rajonale	Gjithsej inspek- time Media	Punëmarrës të evidentuar	Punëma- rresë femra
Berat	2	2	0
Dibër	0	0	0
Durrës	3	6	4
Elbasan	10	55	25
Fier	6	11	3
Gjirokastrë	4	48	17
Korcë	4	8	0
Kukës	2	15	5
Lezhë	0	0	0
Shkodër	5	36	7
Tiranë	5	224	79
Vlorë	6	47	16
Gjithsej	47	472	164

Sipas Inspektoriatit të Punës, rreth 9% e punëmarrësve janë konstatuar të punojnë mbi 40 orë në javë dhe 1.2 % mbi 48 orë në javë. Për 1.5 përqind të punëmarrësve të evidentuar kryejnë leje vjetore të paguar nën 28 ditë kalendarike.

a. Moszbatimi i kontratave dhe/ose mungesa e kontratave

Çështja e mungesës së kontratave të punës është pohuar edhe nga gazetarët e intervistuar për këtë studim (16.67% deklaruan se nuk kanë kontratë pune, ndërsa 13.33% thanë se kjo ishte deri diku e vërtetë.) Ajo që vihet re, megjithatë, është që ky shqetësim konsiderohet i tejkaluar për mediat e mëdha/të konsoliduara, ndërsa portalet dhe mediat e vogla vazhdojnë të mos kenë të tilla, megjithë prirjen për ta formalizuar disi.

Parimisht duhet të kesh një kontratë pune. Zakonisht televizionet e mëdha e kanë dhe e zbatojnë me përpikmëri. Çfarë janë pastaj portale, gazeta, televizione të vogla, nuk ka. Ose kanë një gjë formale me 7 pika që dihen. Por shumica nuk e kanë një kontratë pune.

(gazetar, portal)

Ka TV kombëtare që prej vitesh nuk kanë kontrata.

(gazetar, media vizive)

Filluam punë në dhjetor 2018 me premtimin që do bëheshin kontratat dhe siguracionet në fillim të vitit. Nuk u bënë asnjëherë, për pasojë emisioni nuk doli. Pastaj u futëm në një proces negocimi dhe u krijua një situatë shumë e keqe dhe e rëndë, nëse nuk do tërhiqej pala tjetër, do kishte qenë një padi kolektive shumë e mirë.

(gazetare, freelance)

Një nga elementët që ka dalë gjatë intervistave të thelluara është moszbatimi i kontratave të punës dhe garancive të pakta që ajo ofron për moslargimin nga puna. Pra, sot mund të ketë më shumë kontrata pune në sektorin e medias, por ato nuk përmbajnë kushte favorizuese

për punëmarrësit. Për shembull, në disa tip kontratash të hartuara në mënyrë të njëanshme, ka patur klauzola të shpërpjestuara për shkeljen e afatit të njoftimit për largim nga puna, duke parashikuar një penaltet në masën 2 milion lekë për gazetarin. Edhe pse nuk është zbatuar si penaltet, gazetarët shpjegojnë se kjo klauzolë ka shprehur më së shumti një formë presioni për të mos u larguar në kushtet e ofertave më të mira nga mediat konkurente. Në një rast tjetër, kontrata ka përmblotur detyrimin për të mos punuar një vit pas largimit në media konkurente, praktikisht duke e dënuar me papunësi për një vit gazetarin/en. Ka patur raste kur kontrata është përdorur si pretekst për të mos paguar punën. Një gazetareje i është premtuar që do të vazhdojë të paguhet pasi ka lajmëruar lëvizjen në një media tjetër derisa të gjendet një zëvendësues. Pasi kjo ka ndodhur, ajo jo vetëm nuk është paguar, por është hedhur në gjyq nga media përkatëse për shkelje të kontratës.

Kontratat i kemi me afat apo pa afat, por nuk bën asnjë diferencë. Në çdo rast jemi njësoj të pambrojtur. Kushtet e punës të njëjta janë, ditët e pushimit nuk respektohen, orari i zgjatur gjithmonë.

(gazetar, media vizive)

Gazetarët janë të frikësuar se në rast konflikti me eprorët, gjendet gjithmonë një pretekst për largim nga puna, duke mbushur a posteriori formularët me vërejtje.

Terreni i punës në gazetari mbetet po kaq i rrëshqitshëm edhe sot e kësaj dite. Nuk kemi siguri në punë. Kontrata nuk të mbron. Në një moment që ti refuzon të bësh një stand-up që dëmton biznesin e tjetrit pa hetuar, të thotë drejtori: çfarë thua ti, nuk zbaton urdhrin tim? Dhe shkojnë e mbushin ato formularët me vërejtje.

(gazetare, media vizive)

Edhe në momentin kur ke kontratë mund të hiqesh nga puna për performancë të dobët. Është dhe një nënplikë në kontratë për çdo performancë të dobët merr paralajmërim.

(gazetar, portal)

Përgjithësisht kam patur kontrata, por me periudha kohore, Për shembull firmos një kontratë 1 vjeçare dhe nuk është kujtuar me njeri ta rinovojë atë kontratë, as unë s'jam interesuar. Mund ta quash neglizhencë ose kam menduar ja e konsultova, unë e dua atë vend pune dhe s'kam çfarë diskutoj më shumë. Nuk jam tip kryengritës, e pranoj kur e shoh që s'kam rrugëzgjdhje, sot do ta konsultoja me një avokat kontratën.

(gazetare, media vizive)

Forma e kontratës po ashtu lë për të dëshiruar. Gazetarët pohojnë se në kontratë nuk kanë qenë të specifikuara elementët bazë të marrëdhënies së punës, si përshkrimi i punës, koha e punës, etj.

Në kontratën e punës që kam nënshkruar, ka qenë e cilësuar se do të punoja si gazetar, apo si gazetar i kronikës, por asnjëherë nuk janë specifikuar, kushtet e punës, orari, hyrja dalja, koha e përfundimit të punës, apo të tjera. Kam bërë shpeshherë detyra të cilat nuk më përkisnin mua si gazetar, apo nuk ishin të sektorit tim.

(gazetar, media vizive)

Ka gazetarë që kanë zgjedhur me vetëdije të mos e firmosën kontratën, në këmbim të një rroge të qëndrueshme dhe pagesën e kontributeve shoqërore në mënyrë të rregullt. Në raste të tjera, nuk u është lënë mundësi negocimi për kontratën.

Televizioni ku unë punoj ka një kontratë kolektive prej 5-6 vitesh, që kemi zgjedhur të mos e nënshkruajmë, sepse nuk na pëlqeu. Na u shpërnda, menduam ta negociojmë me secilin, nuk na u ofrua si mundësi. Na u duk e njëanshme, kishte më shumë të drejta për punëdhënësin duke filluar me orët shtesë, etj. Ishte thjesht një propozim, ka nga ata që e kanë firmosur. Përveç njerëzve që merren në provë, kontrata është verbale.
(gazetare, media vizive)

Edhe pse kisha kontratë pune, ajo nuk u respektua nga administratorët e tij, një rrethanë që është shqyrtuar edhe në procesin gjyqësor për pushimin e padrejtë nga puna.
(gazetare, palë paditëse me punëdhënësin)

b. Shpërblimi financiar dhe faktorë të tjerë të lidhur me të

1. Vonesat në paga

10% e gazetarëve të intervistuar për këtë studim thonë që rrogat vonohen më shumë se 5 ditë nga data e caktuar në kontratë, bashkuar me 10% që thonë se kjo është deri diku e vërtetë. 53.33% megjithatë deklaruan se nuk ka vonesa në paga.

Sipas Unionit të Gazetarëve Shqiptarë në vitin 2019, 48% e mediave kanë patur vonesë 2-6 muaj në dhënien e pagës. Megjithëse e denoncuar shumë herë, vonesa e rrogave është një praktikë e përhapur dhe gazetarët e kanë pranuar, madje në disa raste ata shpjegojnë se kjo është një strategji nga ana e mediave për të pamundësuar largimin e gazetarëve.

Procesi si ne marrim rrogat është një muaj me vonesë që mos të largohen gazetarët, të paktën aty ku jam unë. Kishte raste që kalon data 2-3 ditë dhe shkoja trokisja.

(gazetar, portal)

Raportohet se në pjesën më të madhe të mediave të mëdha vonesa e pagave është stabilizuar, sidomos dy vitet e fundit. Vonesa e pagave konstatohet edhe nga gazetarët që janë në kërkim të një pune aktualisht.

Unë jam pa punë realisht dhe kam patur disa oferta, por nuk është se po më pëlqejnë. Shumica e televizioneve ka probleme me pagat. Vonojnë pagat nga 2-3 muaj. Unë këtë nuk e toleroj dot. S'ka kuptim dhe është fyese.

(gazetare, media vizive)

Nuk e kam pranuar kurrë vonesën e rrogave, jam larguar që në muajin e parë që më është vonuar rroga dhe tani punoj i pavarur.

(gazetar, portal)

2. Orët shtesë të papaguara

46.67% e gazetarëve të intervistuar pranojnë se orari i punës i kalon 40 orë në javë. Vetëm 10% e tyre thanë se ky orar respektohet.


Orët shtesë të papaguara, edhe pse artikulohen si shqetësim, në përgjithësi pranohet si veçori e profesionit. Postulati “Gazetari nuk ka orar”, është i gjithëpranuar dhe merret i mirëqenë në momentin që fillon marrëdhënien e punës.

Tani më shumë të gjithë luftojnë për pagën¹³. Në momentin që bie dakord për pagën, do pranosh dhe këto cedimet e vogla që shkojnë jo vetëm nga orari i punës, por dhe nga ana e gazetarit, 8 orë në punë nuk rrimë më, dikur kemi ndenjur.

(gazetare, media vizive)

13 Intervistë me kryetarin e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, Aleksandër Çipa, datë 07.01.2020

Fig. 1. Pagesa e orëve shtesë
Burimi: Intervista me gazetarë, janar 2020



Kjo është një praktikë që pranohet edhe nga administratorët e medias, të cilët i konsiderojnë orët shtesë normale, në varësi të ngjarjeve të ditës. Shembull për këtë u dha tërmeti i 26 nëntorit 2019, ku gazetarët kanë punuar me orë të zgjatura, por edhe janë shpërblyer. Për mediat e mëdha, ky problem konsiderohet i zgjidhur me shtimin e stafëve, ndërkohë që më parë, gazetarët nuk kishin turne. Menaxherja e Burimeve njerëzore të një televizioni kombëtar shprehet:

Televizioni dihet, që ditën e parë që gazetari firmos kontratën dhe fillon marrëdhënien e punës e di që është në terren, e di që duhet të punojë pa orar, e di tipin e pushimeve që ka, në momentin që pranon këto kushte, jashtë tyre nuk dilet kurrë. Nëse më pas mund të ndihet i lodhur, po këto janë pika të kontratës që i ka firmosur dhe i ka pranuar. Nuk mund të them

që kanë orare të stërzgjatura, tani janë dyfishuar stafet, janë një për turn, secili mbulon pjesën e vet, secili duhet të sjellë të paktën 1 kronikë në ditë, ka ditë kur mund të ketë më shumë se një. Për hir të së vërtetës, gazetarët e kanë pak të vështirë të kenë ditë pushimi kur u duhet, ndërsa një kryeredaktor nuk ka më një jetë të vetën, pasi është non stop në punë.

Një sipërmarrëse e mediave online thotë se në biznesin e saj gazetarët punojnë 6 orë në ditë. Është një zgjedhje e saj për të publikuar një numër fiks lajmesh në ditë, në mënyrë që këto të jenë cilësore dhe stafi të ndjehet komod në punën që bën.

3. Informaliteti - mosdeklarimi i plotë i rrogës në bankë

Rreth 43% deklaruan se e marrin rrogën të plotë në bankë kundrejt 23.33% që thanë të kundërtën dhe 6.67% që u shprehën se kjo është deri diku e vërtetë.

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë e konsideron informalitetin në sektorin e mediave problem në mënyrë të madhe të tregut të punës. Një ekonomi e paformalizuar krijon kushte për lulëzimin e korrupsionit dhe shantazhit mbi institucionet shtërore duke minuar pavarësinë e mediave, dhe bashkë me të edhe pavarësinë e gazetarëve.

Informaliteti i lartë sjell një varg problemesh. Vonesat e rrogave, mungesa e kontratave, mungesa e pagesës së kontributeve shoqërore edhe në trajtën e mos derdhjes në thesarin e shtetit, burojnë të gjitha nga informaliteti. Në fund të fundit, pagesa në dorë penalizon gazetarët, të cilët nuk përfitojnë dot kontributet në masën e plotë kur të dalin në pension, ose kur gazetarët marrin lejen e lindjes Për shembull“.

(shoqatë gazetarësh)

Gazetarët janë të vetëdijshëm për këtë problematikë, por thonë se janë të detyruar ta pranojnë informalitetin, për shkak të pagave të vogla dhe mbulimit të shpenzimeve mujore. Ndërsa kontrollin e derdhjes së sigurimeve, ia lënë indiferentizmit dhe besimit të tepruar te punëdhënësi.

Ky fenomen është shumë i përhapur. Besoj se të gjithë e kanë, përveç institucioneve shtetërore. Ka edhe nga ata gazetarë që nuk pranojnë fare sigurimet, dhe kërkojnë që t'i marrin lekët direkt ne dorë, sepse rroga është shumë e ulët.

(gazetar, portal)

Në 22 vite, nuk kam patur asnjë rast të vetëm kur paga të jetë deklaruar e plotë në bankë. Siguracioni i gazetarëve nuk diskutohet fare, them 80-90 përqind e gazetarëve janë me pagesa minimale, nuk u paguhet fare siguracion.


(gazetare, media audiovizive)

4. Mospagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Rreth 23% e gazetarëve thonë se punëdhënësit nuk i paguajnë sigurimet e tyre shoqërore dhe shëndetësore. Bashkuar me 13.3% që thonë se kjo është deri diku e vërtetë, duke supozuar se kjo pagesë mund të bëhet jo në mënyrë të rregullt, shifra shkon afro 36%, ose 10% më pak se gazetarët që thonë se punëdhënësit i paguajnë këto sigurime (46.67%)

Fig. 2. Paga e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Burimi: Intervista me gazetarë, janar 2020



Një prej tyre, tregoi se pas largimit nga një media, ka zbuluar që nuk i ishin paguar sigurimet për 3 vjet rresht. Një tjetër gazetar, pohoi se megjithëse ka në librezën e punës 10 vite në një media, nuk e di nëse janë derdhur sigurimet në emrin e saj.

Nuk e di sa vite kam të siguruara. Kam qenë në një televizion në 2002 -2003 dhe as nuk bëhej fjalë atëhere të paguheshin sigurimet. S'bëhej fjalë në kontratë, ka qenë komplet në të zezë.

(gazetare, media vizive)

Gazetarët pranojnë që ende nuk është e përhapur ndër ta verifikimi i derdhjes së sigurimeve shoqërore me kërkesë individuale, duke u bazuar tek besimi se kompania e kryen detyrën e saj.

Lidhur me pagesën e sigurimeve shëndetësore, përgjithësisht zbatohet një kontratë kleringu me kompanitë që bëjnë reklama në televizione. Për shembull, duke mbuluar sigurimin shëndetësor të tyre. Në rastet

kur gazetarët kanë patur probleme shëndetësore që kërkonin ndërhyrje kirurgjikale apo kura të zgjatura, dëshmohej se janë ndihmuar në mënyrë personale nga pronarët me leje ose me ndihmë financiare.

5. Pagesat e vogla/aplikimi i gjobave

Megjithëse Kodi i Punës nuk e lejon, në media aplikohen gjoba për punonjësit.

Një teknik audio mund të marrë 350 mijë lekë. 8 orë punë. Edhe i dalin sytë nga vendi, i vënë edhe gjoba që pse e preke celularin, 50 mijë lekë gjobë. Janë super të shfrytëzuar dhe po ta shohësh në vitet e fundit, shumica e teknikëve e kanë lënë dhe nuk ja vlen të sakrifkosh kaq shumë për aq pak rrogë.

(gazetare, media vizive)

Brenda mediave nuk ka politika të shkruara për rritjen e pagave. Kjo bëhet në mënyrë individuale, me propozim të drejtuesit të redaksisë. Performanca e gazetarit matet nëpërmjet fitimit të besimit të eprorit, jo me kriteret e bazuara në meritë dhe aftësi. 20% e gazetarëve të intervistuar e besojnë këtë, shtuar me 20% që e besojnë deri diku, duke tejkaluar ndjeshëm 13.3% që mendojnë se ngritja në detyrë bëhet në bazë të aftësive dhe meritës. Ka gazetarë që raportojnë dyfishim të pagës për shkak të performancës brenda një kohe të shkurtër, ashtu sic ka edhe gazetarë që kanë mbetur me të njëjtën pagë prej vitesh, madje në disa raste u është propozuar edhe ulje e saj.

Fitimi i besimit është diçka e rëndësishme- për eprorët dhe për ne. Unë kam patur eksperiencë shumë të mira, për shkak të performancës sime, kam patur rritje page, mua Për shembull më është dyfishuar paga nga koha kur kam filluar dhe këtu nuk hyn shpërblimi i fundvitit, ai është veç.

Performanca varet nga lloji i medias. Nëse je televizion informativ, saktësia dhe shpejtësia është kriter dhe aftësia për të mbajtur gjatë një transmetim live”.

(gazetare, media vizive)

Në redaksinë tonë, e kemi miks grupin e gazetarëve, por mbizotërojnë të rinjtë. Kush ka mbi 10 vjet pune, u rishikohet paga. Nuk kemi politikë të shkruar, por kur e shohin të arsyeshme, shefat e departamenteve kërkojnë rritje rroge. As vlerësim performance nuk kemi.

(menaxhere, burimet njerëzore, media audiovizive)

Në median publike, mungon paga konkurruese ne raport me mediat e tjera kombëtare. Gazetarët e intervistuar për këtë studim mendojnë se paga në TV publik “është shumë e vogël për profilin publik që ka institucioni.”

c. Respektimi i kushteve të punës


1. Mosdhënia e pushimeve javore ose vjetore

Një pjesë e konsiderueshme e gazetarëve të anketuar, 43.3%, shprehen se nuk e kanë pushim ditën e diel kundrejt 13.3% të tyre që e pohojnë një gjë të tillë. Në këtë pikë duhet sqaruar se media bën përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i Kodit të Punës, i cili parashikon se pushimi javor duhet të përmbajë të dielën, sipas nenit 85, pika 2. Ky përjashtim është bërë me një Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr.358 datë 25.03.1996, “Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit në shtypin e folur dhe të shkruar”. Megjithatë kjo VKM parashikon se punonjësit e medias duhet të kenë të paktën 2 të diela pushim çdo 4 javë, dhe në asnjë rast më pak se një të diel pushim çdo tre javë. Për më tepër, kjo VKM parashikon se për punën e kryer të dielave, punëmarrësi përfiton një shtesë page prej 25%, dhe me një pushim 24 orësh pa ndërprerje, në javën paraardhëse ose pasardhëse.

Ndërkohë vetë Kodi i Punës, në Nenin 87, parashikon që në rast pune ditën e pushimit javor, shpërblimi mund të jetë ose shtesë page jo më pak se 25%, ose pushim i pagueshëm, i barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer, plus një pushim shtesë jo më pak se kohëzgjatja e punës.

Por nga intervistat e thelluara individuale dhe në grup, është vënë re se puna ditën e dielë është një normë për një pjesë të madhe të gazetarëve, duke shkelur të gjitha dispozitat e parashikuara më sipër. Madje kaq e përhapur është kjo shkelje, sa një pjesë e konsiderueshme e gazetarëve të intervistuar, e shikonin punën ditën e dielë si diçka normale të profesionit të tyre, duke mos patur ndonjë incentivë për të reaguar publikisht apo gjyqësisht kundër punëdhënësit që i shkel këtë të drejtë. Kjo pjesë diskutohet më gjerësisht më poshtë në seksionin 2.3.c.

Fig. 3. Puna ditën e dielë
Burimi: Intervista me gazetarë, janar 2020



Pjesën e fundjavave gazetarët thonë se e kanë zgjidhur me rotacion me njëri tjetrin për të arritur të bëjnë dy ditë bashkë në javë, ndërsa ditët e festave zyrtare nuk njihen si pushime.

Pjesa e pushimeve vjetore është ndër shkeljet më të raportuara gjatë intervistave të thelluara. Gazetarët, shprehen se pushimi javor nuk njihet, megjithëse në mediat e mëdha kjo konsiderohet e zgjidhur.

Deri para 2 vjetësh në televizion nuk na jepnin një muaj të plotë që na takonin me Kod Pune dhe nuk kishe guximin që të thoje gjë, edhe kaq e keni shumë.

(gazetare, media audiovizive)

Kur punoja në një vend, mbas 13 vitesh pune mora një muaj pushim, tani këtu kam 2 ditë në javë që për mua është arritje.

(gazetare, media audiovizive)

Për ditët e pushimit, është formati i punës si televizion informativ, nuk mund t'i bësh ditët e festave, ato mund të paguhen. Pushimet vjetore janë 2 javëshe, të gjithë e kanë dyjavëshe dhe e kanë pranuar, të gjithë e marrin. Sfida më e madhe është data 31 dhjetor, kush do rrijë në punë, e pranon se s'ke c'bën tjetër, zakonisht u lihet të rinjve.

(gazetare, media audiovizive)

2. Abuzimi psikologjik dhe trajtimi jodinjitoz në punë

Rreth 13% e gazetarëve ndihen të fyer nga toni i zërit të eprorit, po aq (13.33%) ndihen të fyer deri diku. Në shumicë, gazetarët mendojnë se sjellja e eprorëve është brenda kufijve të etikës (36.67% shtuar me 23.33% që shprehen se nuk ndihen të fyer deri diku).

Pozita e gazetarit brenda redaksive është reduktuar në një linjë vertikale me drejtuesin e redaksisë, i cili vendos linjën editoriale në bashkëpunim me pronarët. Si të tillë gazetarët, kryesisht më të rinjtë, ndihen të pafuqishëm për të pretenduar trajtim dinjitoz, sa kohë marrëdhënia e punës është vetëm njëkahëshe dhe e pamonitoruar për cilësinë e punës nga hallka të tjera veç drejtuesit të redaksisë.

Tregu kërkon gazetarë të lirë në lekë edhe që t'i komandos, t'i denigrosh, t'i ulërasësh, kjo është politika që ndiqet tani në televizione që s'dua t'i përmend. Ta denigrosh atë që ke përballë, sepse ai nuk ka fuqinë që të të kundërshtojë ty.

(gazetare, media vizive)

Pronari nisi të ulëriste nga ambientet e zyrës së tij ku i kisha kërkuar ballafaqim për arsyen se përse nuk lejohesha të punoja, pasi rojet ishin urdhëruar që të më ndalonin me forcë të hyja në ambientet e medias, ndonëse nuk kisha një vendim zyrtar me shkrim për largimin nga detyra. Për këtë arsye jam në gjyq me këtë pronar.

(gazetar, freelance)

3. Diskriminimi gjinor/Ngacmimet seksuale në vendin e punës

Çështja e diskriminimit gjinor dhe ngacmimit seksual është nga të paktat çështje, për të cilën gazetarët dëshmojnë kuptim dhe vetëdije të ulët të dukurisë. 40% e tyre nuk kanë dëgjuar për raste të ngacmimit seksual, shumë larg 3.33% që thonë se dinë raste të tilla. Edhe sipas UGSH-së, këto janë raste sporadike dhe jo të përhapura. E njëjta përqindje (3.33%) mendojnë se burrat paguhën më shumë se gratë kundrejt 30% që thonë se paguhën njëllë. Menaxherët e mediave nuk e pranojnë që një gjë e tillë ndodh në institucionet e tyre. Megjithatë

nga intervistat e thelluara, u vu re se ndërsa për gratë kjo përbën shqetësim, për burrat/djemtë justifikohet.

Ka diskriminim gjinor, e shoh te pjesa e drejtuesve, kryeredaktorëve dhe drejtues mediash. Nuk e di pse mendojnë që vetëm burrat e bëjnë këtë pozicion, ka dhe burra të aftë, nuk them, por ka edhe zonja.

(gazetare, media vizive)

Unë di një rast që një gazetë kërkonte një reporter me doemos djalë, sepse vajza do martohet dhe do ketë detyrime. Në televizion i preferojnë më shumë djemtë, po vajzat punojnë më shumë, por paguhen më pak. Reporteret e reja çohen më së shumti në vende të vështira se janë më të shkathëta, kemi vajza shumë të mira dhe kemi djem që janë më të mështë dhe megjithatë mbështetja ndaj djemve, është më e madhe.»

(gazetar, media vizive)

Ngacmimi seksual në vendin e punës ngjalli debat mes të intervistuarëve dhe në disa raste dëshmoi moskuptim të termit, duke e ngatërruar me flirtin apo pranimin me dëshirë të një marrëdhënieje seksuale. Në shumicë, gazetarët pranuan se mos denoncimi i rasteve të tilla bëhet ose për shkak të humbjes së karrierës dhe mosgjetyes së mbështetjes nga kolegët ose familja. Një media u raportua se kishte rregullore të shkruara për këtë **çështje** që tregon hapat që duhen ndjekur nëse dukuria ndodh.

Pa përjashtim, çdo vajzë gazetare që njoh, më ka treguar se bëhet ai ngacmimi fillestar. Kur është puna për të marrë një emision, të vihet në pah kjo gjë (që të bëhet kërkesë për favor seksuale). Mund të të kërkojnë të pinë një kafe. S'ka asgjë. Me përgjegjësi të plotë e them që kam parë mesazhe në telefon kur një vajze i çoheshin sms nga kryedaktori në 2 të natës me kërkesa: ma trego pak gjoksin. Një tjetër po bënte praktikën

në një televizion nëpërmjet njohjeve të familjarëve të saj. Vuri kontakt me një drejtues. Kur arriti kulmin (ngacmimi), i bën bllok dhe nuk shkon në vendin e punës, kishte frikë t'i thoshte familjes se nuk do ta besonin, tani punon në një media tjetër.

(gazetar)

Vajzat nuk denoncojnë, kanë frikë të denoncojnë. Se vijnë te problemet që diskutuam a ke garanci për karrierën tënde? Ideja e paragjykitimit dhe dëmit që sjell në të ardhmen. Duhet t'ia çojë pronarit ose policisë ankesën, nëse s'do të bëjë karrierë.

(gazetar)

4. Mjedisi fizik dhe pajisjet e punës

Kur flasim për kushtet e punës së gazetarëve, duhet mbajtur parasysh se skena mediatike shqiptare është një skenë me kontraste të forta. Ka ente mediatike që u kanë garantuar gazetarëve mjedisin fizik të punës për nga komoditeti, niveli i teknologjisë dhe mundësisë logjistike të realizimit të profesionit. Mediat lokale janë ato që më së shumti vuajnë prapambetjen teknologjike dhe kushte më të vështira pune për shkak të mosinvestimeve. Kontrast ka edhe midis mediave kombëtare, por edhe brenda mediave të të njëjtit pronar.

Megjithatë, gazetarët e mediave të vogla dhe të rretheve ankohen se për shkak të pamundësisë financiare, detyrohen të bëjnë vetë edhe shoferin, edhe kameramanin, ndërkohë që në redaksi të tjera, mjetet e punës janë të amortizuara. Ankesa ka edhe përsa i përket kushteve të higjenës. Pak redaksi ofrojnë mundësi për mensa/kafeteri apo mjedise shlodhëse në mjediset e tyre.

Ambientet ishin aq të vogla sa ndonjëherë për të shkuar në tualet duhej të rrinim në rradhë, ndërsa pronari kishte zyrën dy herë më të madhe se dhoma e gazetarëve.

(gazetar, media vizive)

d. Largime të padrejta nga puna

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë raporton se për vitin 2019 ka patur 68 raste gjyqësore nga gazetarët, kryesisht për largime të padrejta nga puna, mosdhënie të pagave të prapambetura dhe mospagim të kontributeve shoqërore. Largimet e padrejta nga puna ndodhin vazhdimisht, pavarësisht nëse gazetarët i cojnë apo jo në gjyq. Organizatat e gazetarëve thonë se pas largimit të kryeredaktorëve apo drejtorëve të informacionit, fshihen arsye joligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të padrejtë.

Pse nuk i publikojnë mediat arsyet reale të largimit të editorëve? Fatkeqësisht po të kërkojsh nuk jepet as lajmi (i largimit të tyre). Kjo është censurë dhe mungesë transparence ndaj pavarësisë së medias .

(shoqatë gazetarësh)

Është e dhimbshme të shohësh që pas 18-19 vjet pune, gazetarët largohen nga puna me urdhër kryeredaktori.

(gazetar, media vizive)

Largimet nga puna ndodhin edhe në rastet kur ke kontratë pune. Motivet janë të pabaza dhe gjithçka rrotullohet rreth marrëdhënies së gazetarit me eprorin e tij, në këtë rast, drejtuesit të redaksisë. Në rastet kur bëhen shkurtime, procedura nuk është transparente dhe negociimi është individual. Ndodh dhe siç tregohet në rastin e mëposhtëm, gazetarëve u propozohet ulje page nëse duan të qëndrojnë në vendin e punës:

Kryeredaktori më rekomandoi që të pranoja një ulje të pagës, nëse doja të vazhdoja të qëndroja në këtë media. Në të kundërt do të më duhej të largohesha me dëshirë, apo me vendim të pronarit, i cili ligjërisht do të nënshkruhej nga

administratorja. Ajo gjithashtu më ofroi një propozim për ulje page, në të kundërt një tekst dorëheqjeje. Të dyja i refuzova. Në këto kushte, ajo më kërkoi që të firmos një letër në të cilën vihesha në dijeni, se do të largohesha nga puna. Sigurisht që refuzova dhe kërkova që të ma dërgonin me postë në shtëpi”.

(gazetar, palë paditëse me punëdhënësin)

Në mediat online, dëshmohet mungesë hierarkie, çka shkakton pasiguri në rradhët e punonjësve për vendin e punës.

“Ndihej i pasigurt te vendi i punës, sepse pronari është edhe gazetar, edhe kryeredaktor, edhe drejtor informacioni.”

(gazetar, portal)

Në rastet kur gazetarët refuzojnë të përfshihen në konflikte personale, “gjobëvënieje” dhe shantazhi, janë vënë në shënjestër për t’u larguar nga puna. Vendimi merret nga pronari dhe redaktorët plotësojnë dosjen me vërejtje për të përligjur a posteriori largimin në rast të përballjes në gjykatë.

Ata shpresonin që duke mbushur dosjen time me vërejtje të mund të kishin argumente ligjore për shkarkimin, edhe pas njoftimit të shkëputjes së mardhënieve të punës. Unë kam ruajtur mesazhe në telefon, emaile dhe çdo korrespondencë tjetër që do t’i përdor në gjyq për të mbrojtur veten.

(gazetar, palë paditëse me punëdhënësin)

Ekziston edhe një opinion tjetër në rradhët e gazetarëve të mediave kombëtare që largimet e padrejta nga puna janë një problem në rënie, pasi sipas tyre, pronarët janë të vetëdijshëm që gjykatat u japin të drejtë gazetarëve në masë dërmuese.

Nuk është e thjeshtë të pushosh gazetarë nga puna, sepse

humbasin gjithmonë pronarët. Këto i kam raste që i di dhe porositë që janë dhënë në çdo televizion dhe media është: kujdes se Kodi i Punës mbron gazetarët, pavarësisht se ne nuk kemi një ligj për gazetarët. Kodi i Punës është shumë i plotësuar dhe nuk i le hapësirë pronarit të të pushojë pa arsye. Për shembull, ne kemi shumë teknikë të rinj, gazetarë të rinj që nuk janë gjithmonë në lartësinë e detyrës. Dhe si redaktorë e kemi diskutuar si mund ta zgjidhim dhe nga konsultimi që kemi bërë me juristin, kemi thënë që nuk e zgjidhim dot me gjoba, se nuk të lejon Kodi i Punës, thjesht do bërtasësh dhe kaq.

(redaktore, media vizive)

Ky opinion mbështetet edhe menaxherët e mediave kombëtare, të cilët thonë se marrëdhëniet e punës janë formalizuar dhe zbatojnë të gjitha rregullat e shtetit për punësimin e medias.

Ne e respektojmë gjithmonë afatin për largimin nga puna. Në varësi të viteve të punës që ka gazetari, Për shembull. nëse ka mbi 5 vite, lajmërimi bëhet 2-3 javë përpara. Kanë ndodhur dhe raste kur janë larguar edhe para afatit, nëse kanë marrë oferta, gjithmonë duke e zgjidhur me marrëveshje, asnjëherë nuk i kemi zbatuar penalitetet. Në rastin kur ka ndodhur një mosmarrëveshje, ka diçka që nuk shkon, ndaj e shohim me përparësi. Kemi vetëm një proces gjyqësor vitin e fundit me një gazetar që është larguar nga puna, që është fituar në shkallë të parë nga ne, tani është në Apel.”

(menaxhere e burimeve njerëzore, media vizive)

e. Siguria në punë në lidhje me profesionin

Konstatohet shtim i kërcënimeve për shkak të detyrës, sidomos gazetarët e kronikës së zezë. Shumë prej tyre raportuan pasigurinë në vendin e punës dhe lënien pa mbrojtje nga ana e redaksive ku punojnë, pasi këta të fundit, e quajnë problem personal. Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit konsiderohet parësore për vendin, po nëse gazetarët e kronikës së zezë që mbulojnë sidomos pjesën e kriminalitetit, ndihen të kërcënuar për të ushtruar profesionin e tyre, kjo cënon të drejtën e informimit të publikut rreth këtyre çështjeve.

Jo më larg se para një viti u kërcënova nga njeriu më i rrezikshëm në vend. Sot është kërcënuar një tjetër koleg. Ishte hera e parë që më ndodhte në këtë nivel, gjëra të tjera më të vogla i kam zgjidhur vetë. Në një media ku kam punuar 5 vjet, më kanë ardhur te dera e institucionit “për sqarim”, shyqyr që ishte e mbrojtur, e rrethuar, dhe shefat më kanë thënë “dil sqaroji vetë”. Dhe unë i kam zgjidhur personalisht me shoqëri.

(gazetar, media vizive)

Në një rast më kanë paditur në Gjykatën e Lartë, pavarësisht se unë nuk isha fare në emisionin që bëhej fjalë dhe më thonë nga zyra juridike: mbrohu vetë, se ne përfaqësojmë televizionin. Kam hyrë në arkivë, kam zbardhur materialin, shpenzova lekë për avokatin, dhe u paraqita [vetëm] në gjyq.

(gazetar, media vizive)

Në raste të tjera, gazetarët tregojnë se institucionet shtetërore nuk i marrin seriozisht denoncimet e tyre.

Kam bërë një denoncim për një kërcënim që më vinte nga një i burgosur shqiptar jashtë vendit dhe prokurori me tha: “Ky është në burg, s’ka ç’të bën”. Dosja është aty, vazhdon, por nuk ndihem e mbrojtur.

(gazetare, media audiovizive)

1.2 Analizë krahasimore e shkeljeve të së drejtave të punës së gazetarëve

Ky studim ka evidentuar se shkeljet e përshkruara më sipër nuk përjetohen në të njëjtën formë apo intensitet nga të gjithë punonjësit e medias. Në fakt, kemi vënë re një variacion përsa i përket respektimit të të drejtave të punës, i cili lidhet me llojin e medias ku gazetarët punojnë, pozicionin në punë dhe në hierarki, qytetin ku ndodhet media, si dhe gjininë apo vjetërsinë në punë të gazetarit.

a. Lloji i medias

Sipas të dhënave të studimit, gazetarët e portaleve janë më të predispozuar që të punojnë pa kontrata apo të paguhet me rroga tepër të ulëta. Kjo kryesisht ndodh, për shkak të të ardhurave të pakta të këtyre mediave, por edhe për shkak të llojit të punës, i cili në disa raste nuk kërkon angazhim (në terren apo në zyrë) për të përgatitur lajme. Nga ana tjetër, gazetarët e portaleve vuajnë më shpesh vjedhjen e të drejtave të tyre të autorit, pasi në të shumtën e rasteve ata nuk lejohet të vendosin autorësinë për materialet që përgatisin.

Të drejtat e autorit nuk respektohen. Ne njohim vetëm pronarin e portalit, dhe askush nuk e njeh që aty ka gazetarë shumë të mirë që shkruajnë për atë portal... E pyeta tek media X “si e keni kriterin e emrit?”. Më tha “ne nuk e kemi si traditë që të vëmë emrat”. I thashë “Po si nuk e keni si traditë? Punës time mos i vë as emrin?!”

(gazetar me përvojë, portal)

Ky anonimat i detyruar, e bën më të lehtë për punëdhënësin që ta shkarkojë nga puna gazetarin, ndërkohë që e bën më të vështirë për gazetarin që t'i fitojë të drejtat e tij gjyqësisht, pasi është vështirë të provohet marrëdhënia e punës.

Një pjesë e mirë e gazetarëve të portaleve nuk e kanë kaluar fazën e anonimatit, pasi shkruajnë pa emra. Kështu që edhe po u zëvendësuan nuk e merr vesh njeri.

(gazetar i ri, portal)

Për më tepër, gazetarët e portaleve ankohen se ndihen të përjashtuar nga komuniteti i gazetarëve, pasi nuk ftohen nëpër konferenca dhe aktivitete të medias, duke qenë se gazetarët e tjerë shpesh nuk i trajtojnë si të barabartë.

Gazetarët e mediave online janë inekzistentë, qoftë edhe në këto takimet që bëhen... Nuk ka një status për gazetarët online, nuk vlerësohen nga komuniteti. Shumica thonë portale, por unë e quaj veten gazetare.

(gazetare e re, portal)

b. Qyteti ku ndodhet media apo gazetari


Të dhënat e këtij studimi sugjerojnë se ka një diferencë të madhe përsa i përket kushteve të punës në redaksitë e mediave që ndodhen në Tiranë dhe atyre që ndodhen në qytetet e tjera të vendit.

Kushtet e punës ndryshojnë në mënyrë drastike, sapo del nga unaza e Tiranës. Nuk mund ta marrësh me mend nivelin e keqtrajtimit që iu bëhet gazetarëve në rrethe, apo qoftë edhe korespondentëve të mediave kryesore. Është gjynah!

(gazetare me përvojë, media audiovizive)

Fig. 4. Numri total i punonjësve në bazë të inspektimeve, 2019

Burimi: ISHPSHSH 2020



Siç parashtrohet më sipër, Inspektorati i Punës (ISHPSHSH) raporton se gjatë vitit 2019 ka inspektuar 47 media nëpër rrethe, ku ka gjetur 472 punonjës në total. Ndërkohë që vetëm në Tiranë, nga 5 inspektime të kryera ka gjetur 224 punonjës (ISHPSHSH, 2020).


E ndërkohë që Inspektorati raporton një situatë normale, gazetarët e intervistuar për këtë studim, kanë paraqitur një realitet krejt tjetër. Ata kanë raportuar se ka një diferencë mes korespondentëve të medias shtetërore dhe atyre private. Sikurse edhe një diferencë mes gazetarëve të medias lokale dhe korespondentëve të mediave kombëtare me qendër në Tiranë.

Përsa i përket korespondentëve të mediave private, ata raportojnë se pjesa më e madhe e tyre punojnë në kushte informale, ku pagesa bëhet për kronikë, dhe jo përmes bankës. Shumë prej korespondentëve iu duhet të udhëtojnë në Tiranë për të marrë në dorë pagesën e tyre, çka është një shpenzim i konsiderueshëm për ta. Nga ana tjetër, Inspektorati i Punës raporton se në të gjithë Shqipërinë ka gjetur

vetëm 4 punonjës informal. Megjithatë, është interesante që në qytetin e Beratit, inspektorati raporton se ka inspektuar 2 media, dhe ka gjetur gjithsej 2 punonjës, ndërsa në Korçë ka inspektuar 4 media dhe ka gjetur gjithsej 8 punonjës (ISHPSHSH, 2020). Kjo tregon ose se në këto qytete Inspektorati ka inspektuar media që punojnë me vetëm një apo dy persona staf, ose se këto inspektime nuk kanë arritur do të evidentojnë numrin e punonjësve informalë që punojnë për këto media.

Fig. 5. Numri i punonjësve në bazë të inspektimeve në rajone, 2019

Burimi: ISHPSHSH 2020



Raportohet se një televizion kombëtar privat, i cili bën përjashtim nga ky rregull, iu ka caktuar korespondentëve të tij pagën minimale ligjore, megjithatë edhe në këtë rast korespondentët kanë një normë bazë për kronikat që duhet të përgatisin në muaj. Në të gjitha rastet, pagesa për kronikë varion midis 500 dhe 1000 lekë, çka konsiderohet tepër e ulët nga gazetarët.

Gazetarët gjithashtu ankohen se shpenzimet e nevojshme për të përgatitur kronikën, siç mund të jetë udhëtimi për në vendngjarje,

shpesh nuk rimbursohen plotësisht. Për më tepër, ata ankohen se (me ndonjë përjashtim) nuk marrin pagesë ekstra për kronikat e përgatitura gjatë natës.

Orët shitesë nuk paguhen, se ne paguhemi me kronika. Por më ka ndodhur këtë muaj, që më kishin hedhur 30 mijë lekë plus, për një kronikë që pata bërë gjatë natës. Ishte surprizë, se nuk e kanë pas bërë më parë.

(korrespondente, media audiovizive)

Gjithashtu, raportohet se kushtet e punës për gazetarët e mediave lokale, janë më të këqija se në redaksitë e Tiranës, duke përfshirë këtu nivelin e pagës, vonesat e pagës, sigurinë në punë, apo formalizimin e marrëdhënies së punës.

Në këto kushte, shumë nga gazetarët që punojnë jashtë Tiranë, detyrohen të bëjnë dy punë, për të përballuar jetesën. Disa prej tyre punojnë në dy media, ndërsa të tjerë punojnë nëpër institucione publike. Këta të fundit, kanë vështirësi të mëdha për të bërë punën e tyre të gazetarit, pasi përballen edhe me presionin e drejtuesit të institucionit ku punojnë.

I thashë gazetarit X: “po ty po të vjen lajmi tek fytyra. E ke këtu para syve shkatërrimin që po i bëhet monumentit X. Pse nuk shkruan?”. Më tha “Ti thua të humbas vendin e punës këtu në bashki? Kam familje për të mbajtur”. Kështu që, përfundojnë duke bërë shkrime që lavdërojnë kryetarin e bashkisë. Çfarë të bëjnë?

(gazetare me përvojë, media audiovizive)

Gjithashtu, gazetarët e mediave lokale, përballen edhe me një treg shumë më të vogël. Në pjesën më të madhe të qyteteve ka vetëm një apo dy media lokale, ndaj edhe alternativat e tyre për punësim janë shumë të kufizuara. Për më tepër, shpesh pronarët e mediave

lokale, janë persona me shumë ndikim në qytet. Për pasojë, gazetarët e mediave lokale ndihen në një presion shumë të madh, pasi konflikti me pronarin e medias do të thotë që ata mund të humbasin jo vetëm mundësinë e punësimit në një media tjetër, por edhe në institucionet publike. Kjo i bën gazetarët e mediave lokale shumë më tepër vulnerabël ndaj abuzimit, por edhe shumë më të prirur për t'i toleruar këto abuzime.

c. Rubrika dhe pozicioni në hierarkinë e medias

Siç u diskutua edhe më sipër, studimi ka evidentuar se gazetarët e kronikës, të cilët punojnë në terren, janë më të ekspozuar ndaj rreziqeve shtesë, që vijnë nga përballja me subjektet e denoncuar në media. Ky rrezik mund të jetë fizik, ku atyre iu kërcënohet jeta, por mund të jetë edhe financiar, pasi ata kërcënohen me procese gjyqësore. Ndërkohë, siç është diskutuar edhe më sipër, ata ankohen se mediat ku punojnë nuk i mbrojnë as nga kërcënimet fizike, dhe as nga proceset gjyqësore.

Ka qenë një rast kërcënimi me jetë nga burgu, po nga ata të punës nuk të mbronte kush. Unë nuk kisha frikë të përballesha me asnjë lloj gjëje, në profilin e punës që unë bëj, ndodh që të bëjmë edhe gabime, por pa dashje. Por ti nuk mbrohesh as nga pronari, as nga shteti.


(gazetare e kronikës, media audiovizive)

Gjithashtu këta gazetarë janë më të predispozuar për të punuar me orare të zgjatura apo gjatë natës. Inspektorati i Punës raporton se ka evidentuar 9 raste të punonjësve që punojnë gjatë turnit të tretë, dhe 42 raste të punonjësve që punojnë përtej afatit ligjor 40 orë në javë¹⁴.

¹⁴ Shkresë përgjigje Nr 249/1 drejtuar Komitetit Shqiptar të Helsinkit, datë 10.02.2020, nga Arben Seferi, Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqëror

Fig. 6 Rastet e gazetarëve që punojnë mbi 40 orë në javë

Burimi: ISHPSHSH 2020



Por gazetarët e intervistuar shprehen se këto shifra janë shumë herë më të vogla se realiteti që ata shohin në redaksitë e tyre. Gazetarët e terrenit raportojnë se në pjesën më të madhe të rasteve orët shtesë përtej orarit ligjor, apo puna gjatë natës, nuk shpërblehen me shtesë page, pavarësisht se Kodi i Punës (neni 81) e shpreh në mënyrë të qartë detyrimin e punëdhënësit në këtë drejtim.

Nga të dhënat e studimit, është vënë re se në shumë raste rubrika që gazetari mbulon, përcakton edhe rolin e tij në hierarkinë e medias. Kështu, në shumë raste, gazetarët të cilët ekspozohen më tepër në media (si prezantues emisioni apo lajmesh) kanë më tepër fuqi negociuese me punëdhënësin. Për pasojë, duket se ata shpesh arrijnë të kenë paga disa herë më të larta se gazetarët e tjerë, por edhe në një siguri më të madhe në punë. Kjo siguri vërehet edhe në vetëbesimin e tyre dhe prirjen për t'i zgjidhur gjyqësisht konfliktet me punëdhënësin.

Pyetje: Ti vetë do shkoje në gjyq me punëdhënësin?

Përgjigje: Po sigurisht.

Pyetje: Çfarë do të pengonte që mos ta padisje?

Përgjigje: Asgjë.

Pyetje: S'ke ndonjë pengesë si Për shembull duhet të gjesh avokat, duhet shpenzuar kohë gjyqeve etj?

Përgjigje: Jo, jo. Do t'i bëja të gjitha. S'kam asnjë pengesë.

(prezantues emisioni)

Ndërsa gazetarët që konsiderohen si më poshtë në hierarki, janë më pak të predispozuar që t'i zgjidhin gjyqësisht konfliktet me drejtuesit e medias. Ashtu siç diskutohet më poshtë, ky hezitim lidhet me disa arsye ekonomike dhe sociale. Në njërën anë, rrogat e tyre janë shumë të vogla, aq sa nuk justifikon shpenzimet gjyqësore. Në anën tjetër shumë prej tyre priren ta mbivlerësojnë pronarin e medias duke zhvlerësuar rëndësinë e tyre, çka mund të jetë reflektues i brendësimit të pozicionit hierarkik, ku ata i përshtaten psikologjikisht një hierarkie sociale të imponuar.

Pyetje: Çfarë do të pengonte të hidhje në gjyq punëdhënësin tënd?

Përgjigje: Do më pengonte të mos ta çoja vetëm nëse do të dija që pronari aktual do ishte shok me ish pronarin që do hidhja në gjyq. Edhe nëse do e fitoja gjyqin s'do gjeja vend pune, sepse pronaret njihen me njëri tjetrin.

Pyetje: Po pengesë tjetër do kishe?

Përgjigje: Financiare. Do e hidhja në gjyq nëse do kisha një gjendje ekonomike të paguaja gjyqin, dhe të rrija një apo dy vjet pa punë.


(gazetar i terrenit)

d. Vjetërsia në punë e gazetarëve dhe qasje të ndryshme ndaj tyre

Studimi ka evidentuar se ka një diferencë në sjelljen e punëdhënësit ndaj gazetarëve të rinj dhe atyre që kanë disa vite eksperiencë pune. Sipas Inspektoratit të Punës, vetëm 9% e gazetarëve punonjë më shumë se 40 orë në javë¹⁵. Por të dhënat e studimit tregojnë se kjo ndodh shumë më shpesh, dhe ajo ndodh akoma më shpesh me gazetarët e rinj se sa me gazetarët që kanë vjetërsi në punë. Për shembull, 62.5% e gazetarëve të rinj shprehen se punojnë mbi 40 orë në javë, që është limiti i vendosur nga Kodi i Punës. Ndërkohë, përsa i përket gazetarëve me mbi 10 vite eksperiencë punë, një numër dy herë më i vogël, 28.5% e tyre, raportojnë të njëjtën gjë. Ndërsa përsa i përket shpërblimit, 10% e gazetarëve me eksperiencë, shprehen se kur kanë punuar mbas orës 22:00 kanë marrë shpërblim financiar sipas Kodit të Punës. Por, asnjë prej gazetarëve të rinj të anketuar, nuk raportoi të ishte shpërblyer kur kishte punuar gjatë natës, apo përtej orarit maksimal.

Figura 7. Qëndrimet dhe besimet e gazetarëve në lidhje me punën e tyre

Burimi: Anketë me gazetarë, janar 2020



¹⁵ Shkresë përgjigje Nr 249/1 drejtuar Komitetit Shqiptar të Helsinkit, datë 10.02.2020 nga Arben Seferi Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Gjithashtu, ka më shumë gazetarë të rinj se gazetarë me përvojë që raportojnë se punëdhënësi iu drejtohet në mënyrë fyese-përkatësisht 38% dhe 28% e të anketuarve. Gjatë intervistave në grup, gazetarët janë shprehur se kjo diferencë shpjegohet me faktin që shumë prej gazetarëve me eksperiencë, kanë arritur një status social, dhe kanë ndërtuar marrëdhënie sociale me punëdhënësin.

Varet nga sa kohe ke në një punë. Nëse ke tre muaj, zëvendësohesh kollaj, ndërsa nëse ke tre vite nuk është kollaj, pasi punëdhënësi e di çfarë pune bën dhe nuk është se të hedh në rrugë për një fjalë goje.

(gazetar i ri, gazetë)

Nëse ti je një gazetar dhe punon për një kohë të gjatë në media, marrëdhënia nuk është më vetëm punëdhënës-punëmarrës, por është një marrëdhënie shoqërore...Nuk besoj se punëdhënësit do abuzonin me një gazetar, me të cilin kanë punuar për disa vite. Edhe sikur të ketë një zënkë, nuk besoj se punëdhënësi do të të heqë nga puna, sepse kanë një farë miqësie.

(gazetar me përvojë, media audiovizive)

E megjithatë, gjatë intervistës, janë pikërisht gazetarët e rinj që janë më të prirur për t'i zgjidhur miqësisht mosmarrëveshjet me pronarët e medias, krahasuar me gazetarët me eksperiencë. Kështu, kanë qënë plotësisht dakord me pohimin “nëse unë kam një problem me pronarin e medias, do ishte më e ndershme ta zgjidh miqësisht dhe jo përmes gjykatës”, 50% e gazetarëve të rinj, dhe 21% e gazetarëve me eksperiencë.

Klima në redaksitë e mediave duket se nuk është e mirë për gazetarët e rinj, pasi një pjesë e madhe e tyre ndihen të pambrojtur nga kolegët dhe të pasigurtë për vendin e punës. Pjesa më e madhe e të

anketuarve, 87.5%, shprehen se askush nga kolegët e tyre nuk do t'i mbështesë, nëse flasin kundër pronarit të medias. Krahasuar me gazetarët me eksperiencë, ku vetëm 57% e tyre kanë dhënë të njëjtën përgjigje. Gjithashtu, pjesa më e madhe e gazetarëve të rinj, 75% e tyre, shprehen se nuk kanë besim tek gjykata, dhe në rast se ata do të padisin pronarin e medias, vendimi do të jetë në favour të tij.

Këto të dhëna sugjerojnë që gazetarët e rinj ndihen krejtësisht të pambrojtur përballë punëdhënësit të tyre, dhe për pasojë janë më pak të prirur për të luftuar për të rifituar të drejtat e tyre. Kjo shpjegon përse 75% e gazetarëve të rinj të anketuar mendojnë se askush nuk do t'i mbrojë në rast se punëdhënësi i heq padrejtësisht nga puna. Krahasuar kjo me 21% e gazetarëve me eksperiencë që mendojnë të njëjtën gjë.

e. Gjinia

Diskriminimi gjinor dhe ngacmimet seksuale në ambientet e punës janë diskutuar më sipër. Megjithatë, në një analizë krahasimore në bazë të gjinisë, është vërejtur se ndaj grave dhe vajzave gazetare shpesh kryhet një numër më i lartë shkeljesh, krahasuar me kolegët e tyre.

Trajtimi i barabartë garantohet si nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ashtu edhe nga ligji¹⁶. Konkretisht, veç parashikimeve të Kodit të Punës, diskriminimi në bazë të gjinisë ndalohet me ligjin 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Megjithatë, siç u diskutua edhe më sipër, gratë janë shpesh viktimat të ngacmimit seksual në ambientin e punës, çka ndodh edhe sepse kryesisht punëdhënësit

16 Shih Për shembull nenin 18 të Kushtetutës, nenin 14 të KEDNJ, si dhe Konventën nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Diskriminimi në fushën e punës” (1958), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.8086, datë 13.03.1996

janë burra, të cilët shfrytëzojnë pushtetin e tyre. Kur u pyetën për këtë temë, 25 % e gazetarëve të anketuara, u shprehën se ndihen nën tryzni prej eprorëve burra. Ndërkohë 31% e tyre u shprehën se njohin raste ku koleget e tyre janë ngacmuar seksualisht në ambientet e punës.

Këto shifra janë tepër shqetësuese dhe kërkojnë një hetim të thellë, i cili ka qenë përtej objektit të këtij studimi. Kodi i Punës, neni 32, detyron punëdhënësin që të mbrojë personalitetin e punonjësve duke marrë të gjitha masat që t'u garantojë një mjedis pa ngacmime seksuale, apo sjellje denigruese. Por ngacmimi seksual është edhe vepër penale e parashikuar me dënim deri në shtatë vite burg në Kodin Penal, neni 108/a. Ndërsa neni 105 parashikon se marrëdhënia seksuale duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë dënohet deri në tre vite burg. Për këtë arsye, është punë e organeve ligjzbatuese që të evidentojnë veprën penale dhe ta ndërkohë atë.

Njëkohësisht, edhe personat që kanë dijeni për ngacmimet seksuale brenda redaksive kanë detyrimin ligjor që t'i kallëzojnë ato tek organet kompetente. Në këto kushte, mediat kanë detyrimin të ngrenë mekanizma të brendshëm që evidentojnë rastet, t'i raportojnë ato në organet ligjzbatuese, dhe të marrin masa administrative. Mirëpo gjatë këtij studimi nuk arritëm të evidentonim ekzistencën e këtyre strukturave nëpër mediat përkatëse.

Nga ana tjetër, janë raportuar edhe raste sporadike kur gazetaret vajza ndihen të objektifikuara nga komentet apo sjellja e të ftuarve nëpër emisione, një pjesë e të cilëve janë personazhe publike me pushtet. Mbetet për tu parë se sa të përhapura janë këto sjellje, por vlen për tu theksuar se mediat duhet të marrin masa për të luftuar këtë fenomen, dhe për t'i garantuar gazetarëve vajza dhe gra një mjedis të sigurtë pune, duke i mbrojtur ato jo vetëm fizikisht, por mbi të gjitha dinjitetin e tyre njerëzor.

Një shkelje tjetër që gazetaret gra përjetojnë është respektimi i lejes

së lindjes, e cila në shumë raste nuk iu garantohet e plotë. Raportohet se edhe në rastet kur punëdhënësi ua njeh lejen e lindjes, duke qënë se në shumë raste rroga e tyre nuk deklarohet e plotë, shpërblimi që gazetaret gra marrin është shumë më i vogël seç duhet të ishte në të vërtetë.

Pjesa e [lejes së] lindjes një vjeçare nuk bëhet fjalë. Një herë 3 muaj, një herë 4 muaj. Nuk garanton siguri në punë. Thotë [pronari] “më duhet një gazetar për pozicionin që ke, por nuk më vjen njeri për 6 muaj ose një vit.” Kështu që detyrohesh të shkosh. Te [shtatëzania e] dyta i mora 35 ditë para lindjes, por kemi dhe pagesën, që nuk deklarohet e gjitha. Në 22 vite, nuk kam patur asnjë muaj kur të jetë deklaruar [paga] e plotë në bankë, pra me sigurime...


(gazetare, shtypi i shkruar)

Lejet e lindjes merren, po jo të plotë se ngaqë s’kanë deklaruar pagën e plotë, rroga u del e vogël nga sigurimet, ndaj kthehen në punë që muajin e dytë ose të tretë, se nuk paguajnë dot qiranë me atë pagesë.

(gazetare, media audiovizive)

Gjithashtu, gratë gazetare duket se ndihen më pak të mbështetura nga komuniteti i gazetarëve. Kështu, 62.5% e gazetarëve, dhe 33.3% e gazetarëve të anketuar, u shprehën që në rast se punëdhënësi i shkarkon padrejtësisht nga puna askush nga kolegët, apo shoqatat e mediave nuk do reagojë. Gjithashtu, 81% e gazetarëve, dhe 57% e gazetarëve të anketuar, u shprehën se nëse flasin publikisht kundër pronarit të medias, asnjë prej kolegëve nuk do t’i mbështesë. Megjithatë, duket se gazetaret kanë mbështetjen e familjes së tyre nëse vendosin të padisin pronarin e medias. Vetëm 19% e tyre shprehen se familja e tyre do t’i kritikojë nëse padisin pronarin e medias, ndërkohë që 58% e gazetarëve e shprehën këtë shqetësim.

Fig.8. Pse gazetarët nuk denoncojnë shkeljet e të drejtave në punë
Burimi: Intervista me gazetare, janar 2020



Ky studim ka nxjerrë në pah se edhe në rastet e shkeljeve që përjetohen nga të dyja gjinitë, ka më shumë raste të raportuara të abuzimit me të drejtat e gazetarëve gra. Për shembull, 44% e gazetarëve të anketuara u shprehën se punëdhënësi iu flet në gjuhë fyese. Ndërkohë që vetëm 16.7% e gazetarëve të anketuar raportuan të njëjtën gjë.

Gjithashtu, duhet theksuar se gratë përjetojnë më keq shkeljet që iu bëhen gazetarëve pavarësisht gjinisë. Për shembull, oraret e zgjatura, apo puna në orët e vona, shpesh kanë një peshë më të madhe për gratë, në ato raste kur atyre iu duhet të përmbushin pritshmëritë familjare të një shoqërie me mentalitet patriarkal që e inkurajon rolin e gruas si përgjegjëse për punët e shtëpisë.

Në përmbyllje, megjithëse 81% e gazetarëve gra shprehen se punojnë më shumë se 40 orë në javë, ato raportojnë të jenë më keq ekonomikisht se sa gazetarët burra. Siç diskutohet edhe në kapitullin tjetër, kjo situatë ekonomike, i pengon gazetarët që t'i rifitojnë të drejtat e tyre gjyqësisht. Kështu, 68% e gazetarëve të anketuara shprehen se nëse do të padisin punëdhënësin, situata e tyre ekonomike mund të përkeqësohet edhe më tepër.

KAPITULLI 2

2.1 Mjedisi mediatik që lejon shkeljen e të drejtave të gazetarëve (tregu)

Para se të analizojmë faktorët që pengojnë gazetarët të reagojnë publikisht apo gjyqësisht në mbrojtje të të drejtave të tyre të punës, është e nevojshme të analizojmë mjedisin mediatik ku ata veprojnë, dhe raportin e forcave mes palëve. Në këtë studim kemi evidentuar të paktën katër faktorë që e dobësojnë pozitën e gazetarit, duke lejuar shkeljen e të drejtave të tyre të punës.

E para, është burimi financiar për mediat. Me disa përjashtime, burimi financiar i pjesës kryesore të medias private nuk lidhet në mënyrë direkte me popullaritetin e saj. Qytetarët nuk paguajnë për të ndjekur kanalet televizive apo për të lexuar portalet online. Numri i personave që blejnë gazetën është shumë i ulët. Ndërsa reklamat, shpesh përcaktohen nga lidhjet politike të pronarit me pushtetin apo me bizneset kryesore në vend, duke bërë që ato shpesh të shërbejnë më shumë si “një qokë”, se sa si përpjekje e biznesit për të reklamuar produktet e tyre.

Mediat e mëdha fitojnë nga reklamat dhe nga buxheti që i jepet si televizion kombëtar... Por qeveria t'i ndan reklamat. A ndau qeveria përpara shumë vjetësh, që i dha nga 2 milionë euro për procesin e digjitalizimit, që morën 3 televizione? A është një mbyllje goje kjo që të jep qeveria nga 2 milionë euro për procesin e digjitalizimit ndërkohë që duhet ta bësh vetë? ...qeveria cilësohet si kryesore, si shpërndarës i tregut

të reklamës, se orienton biznesin, orienton keto oligarkët... por edhe mund të pengojë një biznes që të mos reklamojë në një media të caktuar. Për shembull. pronari i një mediaje ku punoja unë ankohej se qeveria i pengonte bizneset që të reklamojnë aty.

(drejtues, media audiovizive)

Në këto kushte, një pjesë e madhe e mediave nuk arrijnë të mbulojnë dot shpenzimet e tyre. Prandaj shpesh ato mbështeten nga një sponsor, i cili mund të jetë një person i lidhur me një parti politike, një grup kriminal¹⁷, ose një biznesmen me biznese të tjera në sektorë si ndërtimi, nafta, lojërat e fatit, sektori bankar apo arsimi privat. Në këto raste, pronari i medias, mund ta përdorë median si një mjet presioni ndaj zyrtarëve publik, për të përfituar prej tyre leje, liçenca apo tendera.

Në raste të tjera, media vepron si “gjobëvënës”, duke shantazhuar me publikimin e lajmeve që dëmtojnë imazhin e personave publik. Dhe këta të fundit zgjedhin të paguajnë për mospublikimin e lajmit.

Në shumë raste kam vënë re se gazetarët duhej të bënin lajme që deri diku ishin shantazhuese për drejtues institucionesh, apo drejtues të kompanive të ndryshme private. Kjo kishte si qëllim zhvatjen e fondeve dhe parave prej tyre që do të vinin në formën e reklamave. Unë personalisht kam pasur disa raste të tilla.[...]Shkrimet kundër X vazhduan për disa javë, derisa ato u ndalën në mënyrë të menjëhershme. Më pas në televizion, nisën të shfaqeshin lajme publicitare në favor të kompanisë X, por edhe shfaqje spotesh publicitare me pagesë.

(gazetar me përvojë, media vizive)

17 Besfort Lamallari (Zv/Ministër i Brendshëm) në emisionin Opinion, Shtator 2018

Kanë qënë edhe më përpara që vinin gjoba. Unë kam gati 20 vjet që merrem me media. Edhe më përpara viheshin gjoba, por jo kështu. Kurrë më parë nuk ka qënë gjobëvënia në stad institucional, siç është bërë tani.

(gazetar me përvojë, media audiovizive)

Në kushte të tilla, kur media nuk i gjeneron të ardhurat nga krijimtaria e gazetarëve/profesionistëve të tjerë, por nga “gjobat” apo “qokat”, pronarët e medias nuk kanë interes financiar për shërbimet cilësore të gazetarëve. Në fakt, ky lloj modeli gazetarie, ka sjellë brenda redaksive figurën e “gazetarit kamikaz”, i cili mbahet në punë për të bërë qoka dhe kronika me porosi. Shërbime të tilla mund t’i bëjë kushdo, sepse nuk kërkojnë trajnim të specializuar. Madje mungesa e profesionalizmit dhe etikës profesionale janë një avantazh. Për pasojë, gazetari profesionist është shumë i dobët në tavolinën e negocimit, duke e patur të vështirë të pengojë shkeljen e të drejtave të tij të punës.

Burimi kryesor i të ardhurave të mediave janë bizneset që kanë [...]. Gazetarët përdoren për qoka, goditje selektive për të përfituar pronarët.

(gazetare, media vizive)

Nuk e dimë më kush quhet gazetar, nuk kemi status. Vjen dikush nga qielli të zëvendëson për 5 minuta, ty që ke punuar 20 vjet në media.

(gazetar, media vizive)

Mediat online, të cilat kanë një potencial për tu vetëfinancuar nga reklamato online, nuk e kanë arritur këtë objektiv. Të dhënat e studimit tregojnë se megjithëse shpenzimet e një portali janë shumë të ulëta krahasuar me median tradicionale, dhe pavarësisht se numri i leximeve (klikimeve) ka rëndësi për reklamato, as ato nuk arrijnë dot të vetëfinancohen plotësisht. Një nga sfidat e tyre është konkurenca

e drejtëpërdrejtë me Google, Facebook dhe Instagram, pasi vetë portalet e marrin audiencën e tyre nga këto kompani ndërkombëtare. Për pasojë, shumë kompani që operojnë në Shqipëri preferojnë të reklamojnë direkt në këto kompani ndërkombëtare, se sa të reklamojnë nëpër portalet shqiptare.

Duhet të paktën 40 mijë euro në vit për një portal. Nuk të del me reklama online. Ke filluar me 4 - 5 gazetarë që janë tërë kohës duke bërë lajme. Ndërkohë ke dhe boost [në Facebook] që i bën për të rritur shikueshmërinë. Pra patjetër që ose i financon dikush ose realisht kanë hedhur shumë lekë [investim], që uroj t'i marrin prapë mbrapër shembullt.

(pronar media, portal)

Këto para nuk vijnë dot vetëm nga reklamat, i mban dikush që ka interesa politike ose interesa të tjera në varësi të portalit, politik, kulturor.

(gazetar, portal)

Së dyti, është marrëdhënia “simbiotike” mes pronarëve të medias dhe shtetit. Institucionet shtetërore të ngarkuara nga ligji për të monitoruar marrëdhëniet e punës në media janë Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT). Të dyja këto inspektorate janë në varësi të Ministrisë së Financave. Këto institucione kryejnë inspektime në subjektet mediatike, por raportet e tyre nuk reflektojnë me realitetin e përshkruar nga burimet e tjera të këtij studimi apo nga studime të tjera të kryera në këtë fushë. Siç u diskutua edhe më sipër, ISHPSHSH raporton një numër shumë më të vogël të shkeljeve të evidentuara, se sa ajo që raportojnë gazetarët, apo studime të tjera të mëparshme¹⁸.

18 Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, Tregu i punës në media. Tiranë: IDRA, 2019

E megjithatë më shumë se saktësia në evidentimin e shkallës së problemit, shqetësuese është mungesa e masave ndëshkuese ndaj pronarëve të medias. Nga vetë raportet e ISHPSHSH evidentohet se në vitin 2019, Inspektorati ka vendosur gjithsej katër masa administrative, tre prej të cilave kanë qënë “paralajmërim”, dhe një “pezullim”. Madje edhe vetë Inspektorati pranon që me inspektimet e veta “...nuk pretendo[n] që [ka] ezauruar plotësisht respektimin e dispozitave ligjore...” në media¹⁹.

Inspektorati [i punës] vjen dhe bën kontrolle në media. Ka filluar të bëjë. Diku bën, diku jo. Kur lexon raportin e inspektoratit të vjen për të qarë se duket se gazetarët jetojnë në situatë rozë. Megjithëse [inspektorët] e kanë bazën ligjore të vendosin masa administrative ndaj medias, nuk bëhet asnjëherë, sepse janë me marrëveshje të heshtur ose të paheshtur...

(gazetare me përvojë – media audiovizive)

Pyetje: Keni degjuar ndonjë rast ku media është ndëshkuar?

Përgjigje: *Jo, në media jo. Unë nuk kam dëgjuar për vete, se po të kisha dëgjuar, jo se do e bënim lajm [qesh], por do e mbanim për vete si informacion. Nuk besoj që të jetë gjobitur ndonjë pronar mediash, se ka shkelur të drejtat e punëtorëve*

(gazetar me përvojë, shtypi i shkruar)

Kjo “paralizë” e inspektorateve shtetërore, duket të jetë e lidhur me mënyrën se si vepron media, të përshkruar më sipër. Të dhënat nga disa burime alternative, përfshirë dhe intervistat me inspektorë, tregojnë se inspektoratet janë në një pozicion tepër pasiv përballë

¹⁹ Arben Seferi (Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore), Shkresë përgjigje Nr 249/1 drejtuar Komitetit Shqiptar të Helsinkit, datë 10.02.2020, faqe 6.

medias, për shkak të frikës së hakmarrjes nga ana e pronarëve të tyre. Shumë drejtues inspektoratesh preferojnë të qëndrojnë në raporte miqësore me pronarët e medias, pasi i druhen një fushate denigruese mediatike drejtuar institucioneve që ata drejtojnë, apo (akoma më keq) personit të tyre. Gjatë intervistave ka patur raportime për raste episodike të inspektorëve që nuk e kanë kryer punën e tyre lirisht në monitorimin dhe ndëshkimin e punëdhënësve të medias që shkelin të drejtat e punëtorëve.

*Që në momentin e parë që ti shkel në media të bie telefoni...
Ja një rast konkret, flagrant: Në një portal që është shumë i vizituar dhe që ka shumë njerëz, shkuan një grup inspektorësh. Kontroll rutinë le të themi, jo ndonjë gjë e sinjalizuar. Ishin futur brenda dhe gjëja e parë ishte: “Kush je ti? “Çfarë do ti këtu?” “Kush të tha ty të vije këtu?”... Inspektori vazhdoi bëri punën e vet, por pronari bëri telefonatat e veta, dhe drejtori e mori [inspektorin] në telefon dhe i tha “duhet të dilni urgjentisht tani që aty”. Dhe nuk mbaroi aty, por edhe i thirrën në drejtorinë e përgjithshme që të jepnin shpjegim.*

(inspektor tatimor)

Shiko, mediat ose ndjellin frikë ose respekt. Domethënë ne na kanë spiunuar 2-3 herë te tatimet, ndonjë konkurent. Kanë ardhur tatimet, kanë bërë muhabet, na kanë pëlqyer, kanë ikur. Njëherë na ka shpëtuar dikush tjetër. Jo na ka shpëtuar, por qëllloi, rastisi që unë përmenda një emër, ai emri i shkruajti fshehtas dmth, edhe ajo [drejtoresha e tatimeve] tha “lëri”. Por, po të duan, të ngacmojnë.

(pronar i një portali)

Në mes të kësaj marrëdhënieje simbiotike mes pronarëve të medias dhe qeverisë është gazetari, i cili lihet i pambrojtur nga institucionet

shtetërore. Për pasojë, pavarësisht se çfarë parashikon ligji, inspektoratet shtetërore nuk arrijnë të garantojnë respektimin e tij nga pronarët e medias.

Për pasojë, shumë pak gazetarë marrin mundimin të denoncojnë tek këto inspektorate. Sipas ISHPSHSH brenda një harku kohor prej 14 vitesh, vetëm në 6% të rasteve inspektimet janë kryer bazuar në ankesave²⁰.

Së treti, është mungesa e konkurrencës në treg dhe përqëndrimi i lartë i pronësisë në sektorin e mediave. Të dhënat e studimit konfirmojnë gjetjet e studimeve të mëparshme, si kërkimi i MOM, përsa i përket mungesës së konkurrencës mes operatorëve mediatik. Që pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e nenit 62/3 të ligjit për mediat audiovizive²¹, pronësia e medias është përqëndruar në pak duar, siç raportohet edhe nga studimi i BIRN²². Ky shqetësim është ngritur vazhdimisht nga institucionet ndërkombëtare^{23,24}, si dhe reflektohet në raportin e Komisionit Evropian për progresin e Shqipërisë në integrimin evropian²⁵:

[T]ransparenca e mjegullt e pronësisë krijon shqetësime për konkurrencë të ndershme për organizatat e pavarura të medias. Drejtimi editorial i medias private, vazhdon të jetë

20 Arben Seferi (Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore), Shkresë përgjigje Nr 249/1 drejtuar Komitetit Shqiptar të Helsinkit, datë 10.02.2020

21 Gjykata Kushtetuese. Vendim nr.56 datë 20.07.2016

22 Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Të mbyllësh systë ndaj lajmin: Vetëcensura në median shqiptare. Tiranë: BIRN, 2015.

23 Romana Vlahutin (The head of the EU Delegation to Albania). Letter to the speaker of the Parliament. June 19, 2015

24 Erebara, Gjergj. "OSBE kërkon rikthimin e kufizimit të pronësisë në media". *Reporter.al*, Shtator 5, 2019.

25 Komisioni Evropian. Raporti për Shqipërinë 2019. Bruksel: Bashkimi Evropian, 2019.

një subjekt i interesave të politikës dhe biznesit. Financimi i medias është thelbësor për të përmirësuar lirinë e medias...

(Komisioni Evropian, 2019, f.27)

Mungesa e konkurrencës më shumë se nga numri i mediave në treg, vjen si pasojë e bashkëpunimit të pronarëve të medias me njëri tjetrin, të cilët operojnë në kushtet e një oligopoli. Ka raportime se pronarët e mediave koordinohen për pagat e gazetarëve dhe kushtet e punës, duke limituar alternativat e punësimit për gazetarët. Për pasojë, gazetarët nuk kanë alternativa të tjera, në rastet se janë të pakënaqur me kushtet e punës në median ku punojnë.

Mirë që është një treg kaq i vogël, por ky treg është ngushtuar edhe më shumë se këta katër-pesë pronarë mediash kanë bërë një marrëveshje që të mos i marrin gazetarët njëri-tjetrit. Pra, ti jo vetëm që bërë një armik të fuqishëm, por ti nuk gjen më punë në media, sepse nuk të marrin pronarët e tjerë...

(gazetarë me eksperiencë, media audiovizive)

Këto pretendime janë vështirë të vërtetohen, por duhet theksuar se ato përfaqësojnë një perceptim tepër të përhapur mes gazetarëve dhe janë raportuar në mënyrë të përsëritur gjatë këtij studimi.

Shpresa që tregu do të bëhej më konkurrues me hyrjen e operatorëve ndërkombëtarë, si CNN apo Euronews, nuk ka dhënë ende rezultat përse i përket përmirësimit të kushteve të punës për gazetarët në përgjithësi apo në krijimin e alternativave të reja në treg.

Sigurisht që në këtë situatë, një ndikim pozitiv mund ta kishte patur media publike, si Radio Televizioni Shqiptar (RTSH), i cili operon që prej vitit 1961, me një forcë punëtore prej afro 900 vetësh, nga të cilët rreth 100 janë gazetarë. Megjithëse, në këtë media respektimi i Kodit të Punës bëhet në mënyrë rigoroze, ajo ende nuk shihet si një alternativë punësimi nga një pjesë e madhe e gazetarëve. Ky hezitim

vjen kryesisht për shkak të perceptimit se pagat janë të vogla dhe rekrutimi nuk bëhet në bazë të meritës, por në bazë të lidhjeve politike dhe njohjeve personale.

Së katërti, është mungesa e solidaritetit të gazetarëve me njëri tjetrin. Në kushtet kur institucionet shtetërore nuk arrijnë të garantojnë zbatimin e ligjit, gazetarët duhet të vetëorganizohen për të mbrojtur të drejtat e tyre. Mirëpo, organizimi është i pamundur, në rast se mungon solidariteti mes gazetarëve.


Në të gjitha burimet e të dhënave është konfirmuar se gazetarët nuk solidarizohen mes tyre. Gjatë intervistave të thelluara individuale dhe në grup të gjithë gazetarët e kanë ngritur shqetësimin e mungesës së solidaritetit.

Sic shihet në grafikun e mëposhtëm, 41% e gazetarëve të anketuar besojnë se nëse ata do të pushohen padrejtësisht nga puna, askush nuk do të reagojë. Ndërkohë, vetëm 17% e tyre besojnë se nëse do ngrenë zërin kundër punëdhënësit, kolegët do t'iu dalin në krahë.

Mungesa e solidaritetit fillon me mungesën e një vendi social në redaksitë e mediave ku gazetarët mund të shpenzojnë kohë sociale me njëri tjetrin. Dhe vazhdon me klimën e konkurrencës brenda redaksisë apo mes mediave të ndryshme.

Megjithatë, ka një variacion përsa i përket klimës së solidaritetit mes gazetarëve, në bazë të llojit të medias. Është vënë re nga studimi se sa më të vogla mediat, aq më i madh është socializimi mes gazetarëve, për shkak se ambienti i punës është i vogël dhe ata shpenzojnë kohë bashkë. Socializimi është kusht bazë për solidaritetin, pasi është më e lehtë të solidarizohesh me dikë që e njeh, dhe me të cilin ke zhvilluar një marrëdhënie sociale.

Figura. 9. Çfarë do ndodhë nëse një gazetar pushohet padrejtësisht nga puna
Burimi: intervista me gazetarë, janar 2020



Ndërsa tek mediat e mëdha solidariteti është mes grupeve të caktuara, ku gazetarët e terrenit socializohen me njëri tjetrin, ndërsa gazetarët që prezantojnë emisione, socializohen mes tyre. E megjithatë konkurrenca është një nga pengesat kryesore për t'i bërë gazetarët bashkë, prandaj shpesh ka më shumë gjasë që një gazetar sporti të solidarizohet me një gazetar politike, se sa dy prezantues lajmesh me njëri tjetrin.

E thënë kjo me gojën e një gazetari që ka kaluar nga një portal online tek një nga mediat më të mëdha në vend:

Është vërtetuar që sa më i vogël të jetë ambienti, aq më të lidhur janë njerëzit me njëri tjetrin. Sa më i madh të jetë ambienti dhe përgjegjësia për çdo gazetar, aq më e largët është marrëdhënia me njëri tjetrin.

Solidariteti është gjithashtu i rëndësishëm për organizimin sindikal të gazetarëve. Por, shumë gazetarë duket se nuk kanë besim tek

shoqatat e gazetarëve, ndërsa sindikatat e mirëfillta nuk ekzistojnë. Kjo mungesë besimi tek sindikatat mund të lidhet edhe me historinë e sindikatave në Shqipëri. Para viteve 1990 ato ekzistonin në formën e Bashkimeve Profesionale, të cilat në vend që të shërbenin për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve, ishin instrumente në dorën e regjimit, dhe jo rrallë herë përdorshin pikërisht për të shtypur punëtorët. Pas viteve 1990 historia e sindikatave nuk ka qënë pozitive, pasi një pjesë e tyre u korruptuan, duke humbur legjitimitetin, ndërsa një pjesë tjetër ishin shumë të dobëta për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve.

Kjo mungesë besimi e bën shumë të vështirë organizimin sindikal dhe fuqizimin e shoqatave aktuale të gazetarëve.

Shoqatat e gazetarëve nuk e bëjnë dot rolin e sindikatës, sepse nuk e bëjnë dot ndërmjetësin me pronarët. Ne jemi përpjekur si organizatë dy vite rresht që të bëheshim bashkë disa televizione për shkak të nisjes së fushatës zgjedhore para afatit që parashikonte ligji. E filluam 4 TV, mbetëm 3, 2 dhe në fund 1, sepse secili llogariste benefitin dhe nuk shkonte gjëja deri në fund. Kjo vlen edhe për komunitetin tonë, kur nuk bëhemi (bashkë) për rrogat, pretendohet që dikush tjetër të dalë të flasë për ty, megjithëse ai është problem i të gjithëve.

Drejtues i një shoqate gazetarësh)

Në këtë kontekst, disa gazetarë janë shumë të pakënaqur me shoqatat e gazetarëve, pasi nuk kanë parë rezultate konkrete ku ato të kenë arritur të mbrojnë të drejtat e gazetarëve. Megjithatë, siç duket edhe në grafikun e mësipërm, 41% e gazetarëve të anketuar besojnë se nëse ata do të pushohen padrejtësisht nga puna, shoqatat e gazetarëve do të reagojnë.

2.2 Pengesat për të reaguar publikisht – Pse gazetarët nuk reagojnë publikisht për shkeljen e të drejtave të tyre në punë.

a. Faktorët institucionalë (operatorët mediatikë)

a.1 Pozita e gazetarit brenda mediave

Edhe pse kanë Departamente të Burimeve Njerëzore, rekrutimi i gazetarëve bëhet në bazë të njohjeve, pa shpallje të vendeve të reja të punës, pa aplikim dhe pa garë. Madje edhe departamentet e burimeve njerëzore janë të reja si struktura, krijuar 3 vitet e fundit. Deri vonë marrëdhëniet e punës mbaheshin nga zyra e financës dhe punëdhënësi drejtpërdrejt.

Gazetarët nuk punësohen vetëm me procedurë zyrtare rekrutimi, por edhe me referencë të kryeredaktorëve. Mendoj se një pjesë e tyre, për të ruajtur postet dhe pagat disa herë më të larta se të gazetarëve të terrenit kanë lejuar shfrytëzimin dhe largimin e padrejtë të tyre nga puna.

(gazetare, freelance)

Tregu i punësimit funksionon me njohje, në bazë të emrit apo reputacionit që krijon çdo gazetar. Për gazetarët e medias online, që është një vend pa asnjë lloj vlere, është puna më e rëndomtë e gazetarisë, aty funksionon me thirrje, sepse nuk ka, nuk gjejnë, jo sepse ju duhet.

(gazetare, media vizive)

Unë kam hyrë me konkurs televiziv dhe nuk i ndihem borxhli askujt. Kisha kontratë 1 vjeçare, më mbaroi kontrata, u ndërpre marrëdhënia e punës.

(gazetar, portal)

Si kryeredaktor, kam patur raste kur nuk punësoja dot një gazetar, sepse nuk i pëlqente pronarit. Për mua, duhet të forcohet pozita e editorit brenda mediave, sepse rekrutimi është një proces delikat që nuk mund të bëhet nga njerëz jashtë profesionit, editorët janë garancia e përzgjedhjes së gazetarëve me kritere profesionale.

(ish kryeredaktor, media e shkruar)

Nga intervista me drejtuesen e burimeve njerëzore në një televizion, ajo pohon se punësimi bëhet në bazë të rekomandimeve nga drejtuesi i redaksisë. *“Firmoset kontrata dhe për çdo pakënaqësi, negociohet me drejtuesin e redaksisë, qoftë për rritje rroge, qoftë për shpërblim, apo vërejtje.”*

Redaksitë nuk kanë një trajektore zhvillimi për gazetarët që stimulon rritjen profesionale. Paqëndrueshmëria e redaksive dhe lëvizjet e shpeshta të stafëve, krijojnë vështirësi për krijimin e solidaritetit brenda mediave. Gazetarët ndihen të vetëm në reagimet e tyre, pasi nuk kanë krijuar lidhje me gazetarët e tjerë, punonë individualisht, nuk ka frymë grupi. Nuk kanë arritur të bëhen komunitet. Edhe brenda një kompanie mediatike me disa platforma, ka standarde të ndryshme pune.

Gazetarët kontrollohen në publikimet që bëjnë në mediat sociale në llogaritë e tyre private. Një rast që bëri bujë për mosdhënien e rrogave nga një gazetarë televizive u fshi pak orë pas publikimit. Rezultati ishte që rrogat u morën, dhe gazetarja vazhdoi punën.

Mbaj mend njëherë që janë habitur të gjithë, para nja 2-3 vitesh bën dikush një status që “na jepni rrogat” dhe ne u habitëm si ka mundësi. Edhe thashë si guxoi që e bëri këtë gjë, edhe nuk e hoqi njeri. Si ka mundësi që ka dalë hapur? Nga njëra anë bravo, por cilat do të jenë penaltitetet, se mos e heqin, por sigurisht që bravo. Lum si ai që e merr guximin

e i thote gjërat publikisht. Ndoshta i kishte ardhur në majë të hundës dhe s'kishte çfarë të bënte më. Por unë mendova se do ta hiqnin, çfarë do ndodhte, por nuk e hoqën në fakt.

(gazetare, media vizive)

a.2 Mungesa e kushteve për krijimin e sindikatave/unioneve brenda mediave

Brenda mediave mungojnë mekanizmat e ankesës për kushtet e punës. Vendimi merret vertikalisht nga drejtuesi i redaksisë ose pronari, pa i dhënë mundësinë gazetarit/es të parashtrojë opsionet e tij. Mungesa e hierarkisë në marrëdhëniet e punës ose lidhjet e shkurtra bëjnë që të mungojnë hallkat ndërmjetëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës. Negocimi i kontratave bëhet në bazë individuale, jo me vlerësim ose me komision, as me aplikim për një vend pune.

Ajo që është shqetësuese, është që në kundërshtim me ligjin për sindikatat, ku theksohet detyrimi i punëdhënësve për të krijuar kushte për funksionimin e sindikatave të punonjësve, gazetarët dëshmojnë me fakte konkrete se çdo përpjekje që është bërë në këtë drejtim, është asgjësuar në mënyrë të menjëhershme nga pronarët, me kosto personale të nxitësve /udhëheqësve të lëvizjes sindikaliste.

Një rast konkret që në vitet 2016-2017 në momentin që filluam të kishim probleme me rrogat, thërrasim pronarin dhe bëmë një kërkesë për informim. Ata e quajtën peticion, nënshkruam 15 vetë. Kërkonim të na deklarohet në bankë rroga e plotë, të na paguhet në kohë në datën e përcaktuar; kishim futur dhe ca pika të tjera, gjithsej 5 pika. Kjo turbulloi gjithë redaksinë, erdhi pronari që nuk kishte ardhur deri në atë moment të shihte si punonim dhe e quajti kryengritje dhe tha «nuk lejoj sindikalizmin, nuk lejohen sindikatat në këtë punë» dhe si përfundim një gazetare iku nga puna, sepse ajo e dorëzoi kërkesën. Dmth, ajo u tregua me rebelja e grupit

*tonë, e pushoi si fillim, pastaj e ktheu dhe pastaj u largua.
E pushoi në syrin e 15 vetëve, kjo ndodhi me sindikatën dhe
çfarë kërkuam? Të drejtat tona, a nuk na takon të marrim
pagat në datën e caktuar?*

(gazetare, media vizive)

*Ka ndodhur që dikush ka ngritur zërin dhe më pas është
larguar nga puna. Rast konkret që janë larguar ka dhe kur
nuk kanë qenë dakord me kushtet, janë larguar.»*

(gazetar, media vizive)

a.3 Embargo televizive ndaj deklaratave të Unionit të Gazetarëve

Një nga format e reagimit publik është solidarizimi me Unionin e Gazetarëve në rastet kur denoncon shkelje të të drejtave të punës ose pjesëmarrje në protestat që thirren. Ajo që ndodh është që asnjë protestë për kushtet e punës së gazetarëve nuk lejohet të transmetohet në televizione ose media të tjera. Në këto kushte, gazetarët hezitojnë t'i bashkohen protestave të Unionit, pasi ata e dinë që ajo kronikë nuk do të transmetohet në mediat ku ata punojnë. Ka një marrëveshje të heshtur midis pronarëve të medias për këtë çështje, duke ndaluar çdo pasqyrim të veprimtarisë së Unionit. Kryetari i Unionit thotë se ky pozicion i ka shkaktuar kosto personale edhe si profesionist, pasi duke folur për të drejtat e gazetarëve, i është vendosur embargo televizive në një televizion për 10 vjet dhe në një tjetër për 5 vjet.

b. Faktorët ekonomikë dhe socialë

b.1 Mungesa e solidaritetit mes gazetarëve

Në 30 vjet demokraci, gazetarët nuk ia kanë dalë të bëhen një grup homogjen, që të llobojë si një grup interesi për të drejtat e veta. Gazetarët thonë se mjedisi është shumë konkurrues, dhe ka dallime

midis atyre që bëjnë emisione dhe gazetarëve në terren, duke filluar nga paga, stili i jetesës, etj.

Ne kemi krijuar modelin e gazetarëve të pasur me gazetarin e shokut të të pasurve. Ky është një model që ti nuk mund të presësh që ky të mbrojë. Modeli i gazetarisë është i keq, por nuk i shoh që të bashkohen.

(gazetar, freelance)

Atë ditë që u bë protesta para parlamentit për ligjin antishpifje, më bëri shumë përshtypje që një nga organizatorët e protestës nuk doli. Nuk e di pse, por ndoshta ata mendojnë që mjafton ajo beteja mediatike, ajo te fronti i parë, dhe kur vjen puna për t'u bashkuar me gazetarët e te gjitha niveleve, më të rëndësishmit nuk ishin. Sepse janë në rregull, gjysma janë me pushtetin, gjysmat s'kanë probleme, i kanë të gjitha të garantuara.

(gazetare, media vizive)

Nuk jam tipi i gazetarëve që rrinë me pronarët, hanë dreka dhe darka.

(gazetare, media vizive)

Këta gazetarët e mëdhenj pse nuk flasin? Nuk e di, mbase janë aksionerë. Nuk e di.

(gazetare, media vizive)

Konkurenca është shumë e madhe, sidomos mes atyre që dalin ne ekran edhe ku ta gjejnë që ti ta pësosh se do lulëzojnë vetë. Konkurenca është më e madhe dhe nëse nuk je, unë ndriç më shumë. Kryesisht gazetarët e terrenit janë më të lidhur me njëri tjetrin, kurse prezantuesit nuk kanë miqësi. Gazetarët e terrenit ose pjesa e teknikës janë më të lidhur me njëri tjetrin.

Kanë interesa të përbashkëta, janë pjesa që janë të paguar më keq.

(gazetare, media vizive)

b.2 Mungesa e besimit/pakënaqësia nga Unionet

Gjithashtu midis gazetarëve mungon kultura sindikale dhe mbizotëron pakënaqësia për shoqatat që janë aktualisht në mbrojtje të gazetarëve. Perceptimi i gazetarëve të intervistuar për shoqatat aktuale shkon nga mohimi kategorik i çdo lloj lëvizjeje që Unionet kanë bërë, - kjo buron kryesisht nga raste personale dhe për shkak të mosinformimit-deri tek njohja e disa arritjeve, si Për shembull në rastin e ligjit kundër shpifjes, me kërkesën që të ketë më shumë ndërveprim dhe përfshirje të gazetarëve të thjeshtë. Gazetarët nuk e shikojnë si problem kuotën vjetore të anëtarësisë që duhet të paguajnë si anëtarë të Unionit, por nuk janë të bindur për vlerën e marrjes së Kartës së Anëtarësisë.

Nuk kemi organizata që të mbrojnë të drejtat tona. Kemi shoqata gazetarësh, po konkretisht flasin shumë pak dhe në mënyrë shumë preferenciale. Për ca çështje shprehen, por nuk kanë ndikim. Është ngritur disa herë për çështjen e rrogave, por shuhet direkt nga ata që kanë influencë.

(gazetare, media vizive)

Funksionojnë pak sindikatat dmth. Pak protesta që u bënë, më shumë (pjesëmarrës) janë portale. Disa ishin gazetarë, të tjerët ishin juristë apo profesione të tjera. Po marr rastin që [shumë] gazetarë janë pronarë portalesh, unë nuk i pashë, pashë studentë dhe disa grupe shoqërore dhe shumë pak gazetarë.”

(gazetar, portal)

Ndërveprimi i unioneve me gazetarët është zero. Në 7 vjet që

punoj gazetare, nuk di të jemi mbledhur njëherë.

(gazetar, media vizive)

Pagesa nuk është e lartë për kartën, po sa kohë ajo nuk vlen për asgjë, gazetarët stepen. Jashtë (shtetit), Unionet u japin rrogë gazetarëve të pushuar nga puna derisa të gjejnë punë tjetër

(gazetar, media vizive)

b.3 Indiferenca, mungesa e kulturës ligjore dhe moskuptimi i të drejtave

Megjithëse shkalla e vetëdijes së gazetarëve për të drejtat në vendin e punës është rritur, ata pak interesohen për zbatimin e tyre. Në disa raste, mbijetesa dhe dritëshkurtësia janë faktorë që ndikojnë. Në rastet e ngacmimit seksual demonstron një moskuptim i thellë i dukurisë nga ana e gazetarëve meshkuj kryesisht, por ka edhe vajza e gra që fajësojnë viktimën e ngacmimit seksual duke filluar nga veshjet ose “ka dashur vetë.” Shqetësues është fakti se dukuria mohohet në mënyrë kategorike (“sot nuk të detyron askush”) dhe kjo bëhet nga gazetarët e rinj. Shqipëria ka probleme të raportimit seksist, diskriminues e paragjykses, po kjo kërkon që gazetarët në rradhë të parë të zhvillojnë një kuptim të drejtë rreth këtyre dukurive.

b.4 Gjendja jo e mirë ekonomike e gazetarëve dhe frika për humbjen e vendit të punës

Shumica e gazetarëve janë ose të rinj, ose familjarë që jetojnë me qera, ose kanë kredi për të paguar. Në këto kushte, humbja e vendit të punës për shkak të pjesëmarrjes në veprimtari sindikale, sic është dëshmuar në citimet më lart, e bën pothuaj të pamundur reagimin publik të tyre lidhur me të drejtat e punës.

Gazetarët janë qëniet që punojnë 24 orë për bukën. Gjithë të tjerët, edhe pronarët dhe menaxherët e medias, i kanë kapur gazetarët te buka, te pamundësia e tyre për të bërë një punë tjetër, për t'u ingranuar diku tjetër.

(gazetare, media e shtypur)

Sot mund të ketë disa që reagojnë për vonesën e rrogave, por nuk e bëjnë, sepse ngelin borxh tek ata dhe nuk i marrin kurrë lekët. (Jep shembull) S'kanë ku shkojnë se ngelin pa punë.

(gazetare, media vizive)

Nëse mua do të më hiqnin nga puna, shokët e mi do kthenin kokën për të punuar. S'reagojnë, sepse ka dhe familjarë që kanë detyrime më të mëdha se unë që s'jam familjar, dhe kanë dhe nga 2 muaj pa marrë rrogën dhe nuk flasin sepse s'kanë një vend tjetër më të sigurt.

(gazetar, portal)

U thashë: sikur nja 4 -5 veta mos ti shkojmë në punë besoj se nuk i vonojnë më. Për një moment të gjithë ngelën, po e mendonin, në atë mendim prapë nuk e bindën veten që ta bënin, sepse frika që do i pushojnë nga puna njëkohësisht, mund të bëheshin shembull dhe mbështetja ime për personin apo kolegun mund të shkonte deri këtu..

(gazetare, media vizive)

c. Faktorët psikologjikë-kulturorë

c.1 Klima pesimiste

Midis gazetarëve mbizotëron një klimë pesimiste për rregullimin e gjendjes së të drejtave të tyre të punës. Duket se shumica e tyre janë pajtuar me gjendjen, janë dorëzuar, duke besuar se kjo është një situatë që nuk mund të ndryshohet, sepse shkaktohet nga faktorë jashtë tyre, dhe që janë më të fuqishëm se ata. Puna e gazetarit nuk shihet më si diçka me reputacion në shoqëri ose që sjell ndikim pozitiv. Në këto kushte, gazetarët besojnë se reagimi publik i tyre nuk do të sjellë asgjë të re, ndaj janë në kushte mbijetese.

Gazetarët shihen dhe trajtohen si skllevër; besoj në asnjë vend në botë ose në pak vende mund të ketë që figura e gazetarit është kaq e përçmuar sa në Shqipëri.

(gazetare, freelance)

Më ka zhgënjyer çdo gjë në gazetari, duke filluar nga tregu i punës. Gazetari është si tabelë qitje nga të gjitha palët. Tani të japin yllin, dhe tani të rrëzojnë, sipas situatave, interesave dhe momentit në të cilin ndodhesh.

(gazetare, portal)

E keqardhur konstatoj se sot gazetaria është një profesion shumë i pasigurt. Vitet e fundit gazetarët përballen edhe me një gjuhë urrejtjeje të zyrtarve të lartë dhe me kërcënime të organizatave kriminale, duke detyruar dhjetra prej tyre të kërkojnë siguri për jetën në vendet e BE-së. Personalisht për afro tre vjet jam përndjekur, kërcënuar, pushuar nga puna dhe nuk jam lejuar të kthehem në media nga influencat e censorëve.

(gazetare, palë paditëse me punëdhënësin)

Nëse do të gjeja një punë me kushte më të mira, edhe pse kam 20 vjet në media, do ta lija profesionin.

(gazetare, media vizive)

2.3 Pengesat për t'i rifituar të drejtat gjyqësisht

Faktorët që i pengojnë gazetarët të ndjekin rrugët gjyqësore për të rifituar të drejtat e tyre, përshkruhen në mënyrë të detajuar në këtë kapitull. Këto faktorë janë analizuar në mënyrë të thelluar dhe janë rikonfirmuar përmes një triangulimi metodologjik.

2.3.a Faktorët ekonomikë dhe socialë (shoqëria)

Nëse një gazetar do të vendosë t'i rifitojë të drejtat e tij gjyqësisht, ai duhet të përballet me një mjedis ekonomik dhe social që i dekurajon sjellje të tilla.

Në fillim të këtij kapitulli u analizua tregu mediatik në Shqipëri dhe raportet e forcës mes gazetarëve dhe pronarëve të medias. U shpjegua se arsyet që lejojnë punëdhënësin që të abuzojë me të drejtat e gazetarëve janë: aftësia vetëfinancuese e medias, marrëdhënia “simbiotike” mes pronarëve të medias dhe zyrtarëve publik, mungesa e konkurrencës në treg dhe mungesa e solidaritetit mes gazetarëve.

Në tregun mediatik shqiptar ka qindra radio, televizione, gazeta dhe portale, por 80% e audiencës kontrollohet nga vetëm 8 pronarë mediash²⁶. Në këtë treg, pjesa më e madhe e punëdhënësve mbajnë rroga të ulëta, dhe ofrojnë pak a shumë të njëjtat kushte punësimi, të cilat në vetvete e limitojnë lirinë e gazetarëve për të zgjedhur. Nga ana tjetër, mungesa e burimeve financiare e bën tepër të vështirë humbjen e vendit të punës, pasi gazetari jo vetëm që nuk ka rezerva financiare për të përballuar periudhën e gjetjes së një pune të re, por e ka të vështirë të përballojë shpenzimet gjyqësore në rast të një padie ndaj punëdhënësit.

Një faktor tjetër pengues është mënyra se si funksionon tregu i punësimit në media. Të dhënat e studimit evidentojnë se konkursat objektive të

26 Ruci, Ani. “Biznes familiar – Miti i medias pluraliste në Shqipëri”. *Deutsche Welle*, Mars 13, 2018.

punësimit në media janë pothuajse inekzistente. Vetë zyrat e burimeve njerëzore kanë një rol dytësor, pasi rekrutimi i gazetarëve të rinj, por edhe shkarkimet e tyre, shpesh bëhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë (ose nën mbikqyrjen) e pronarit të medias. Një situatë e tillë bën që marrëdhënia e punës të mos jetë institucionale, por personale, duke e bërë gazetarin tepër vulnerabël ndaj opinioneve dhe paragjytimeve të pronarit të medias. Kjo gjë merr një rëndësi të veçantë nëse ka një marrëdhënie sociale dhe solidaritet, në kushtet e një oligopoli, mes pronarëve të mediave kryesore. Një pjesë e madhe e gazetarëve besojnë se mes disa pronarëve të mediave ka një marrëdhënie bashkëpunimi, dhe ata shpesh dakordësohen që të mos pranojnë të punësojnë një gazetar që është larguar nga një media tjetër.

Po shumë gazetarë në dijeninë time nuk bëjnë ankesa, nuk u kundërvihen punëdhënësve të tyre, sepse grupi i pronarëve komunikojnë me njëri tjetrin. Pse u largua? Për çfarë arsye? Dhe meqë iku ashtu [me gjyq] merr referenca negative. Pra [pronarët] komunikojnë, sepse janë një komunitet shumë i lidhur me njëri tjetrin.

(avokat, përfaqësues i gazetarëve në gjyq)

Mbetet për tu verifikuar se deri në ç'pikë pronarët e mediave koordinohen me njëri tjetrin për të mos lejuar kalimin e punonjësve të medias nga një media në tjetrën. Por, në çdo rrethanë perceptimi i gazetarëve është shumë i rëndësishëm, pasi një perceptim i tillë i bën një pjesë të madhe të gazetarëve t'i peshojnë mirë pasojat e padisë gjyqësore ndaj punëdhënësit, nëse synojnë vazhdimin e karrierës profesionale në gazetari.

Tregu i medias në Shqipëri është një treg i vogël. Kështu që po e hodha në gjyq, do të thotë që kjo është një marrëdhënie që dëmtohet një herë e mirë. Dhe është më mirë ta zgjidhësh në mënyrë miqësore, se sa të bësh një armik shumë të fuqishëm.

(gazetar me përvojë, portal)

...Procesi gjyqësor ishte një pengesë shumë e madhe për mua për të rifilluar punë në media. Mënyra se si ndoqa të gjithë historinë e denoncimit duke e ndjekur jo vetëm në drejtësi por edhe institucione... I ka trembur disa redaksi që e dinë si veprojnë dhe kanë frikën e një reagimi [të ngjashëm nga ana ime].

(gazetare me përvojë, palë paditëse ndaj punëdhënësit)

Për të gjitha argumentet e dhëna më sipër gazetarët ngurrojnë të nisin një proces gjyqësor ndaj punëdhënësit të tyre, edhe kur ata përballen me shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të tyre. Madje, ka patur raste kur gazetarët pasi kanë ngritur një padi ndaj punëdhënësit, tërhiqen nga procesi gjyqësor pa pritur vendimin e gjykatës.

Së fundmi, nëse gazetarët do të kishin më tepër besim tek njëri tjetri, çka për pasojë do të sillte më tepër solidaritet mes tyre, atëherë ata mund të kishin bashkëpunuar edhe në mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre. Legjislacioni shqiptar është i mangët për sa i përket Padive Kolektive²⁷, megjithatë duke shfrytëzuar mundësinë që krijon Neni 161 i Kodit të Procedurës Civile, ose edhe me padi individuale por të koordinuara, gazetarët kanë mundësinë të padisnin bashkarisht punëdhënësin në rastet e pushimeve kolektive. Një veprim i tillë, ku një grup i madh punonjësish do të padisnin punëdhënësin, jo vetëm që do të rriste mundësitë e tyre për të fituar, por do të ulte edhe mundësinë për ‘hakmarrje’ nga ana e tij.

2.3.b Faktorët institucionalë (shteti)

Pasi gazetari ka kaluar pengesat sociale për të hedhur punëdhënësin në gjyq, atij i duhet të përballlet me pengesat institucionale. Si të tilla janë koha mesatare e një procesi gjyqësor, kostoja financiare e një gjyqi dhe puna e dobët e institucioneve publike, të cilat do të ndihmonin procesin gjyqësor përmes gjenerimit të provave.

²⁷ Qendra Respublica. *Padia Kolektive*. Tiranë: Respublica, 2018.

Avokatët e intervistuar për këtë studim, të cilët përfaqësojnë në gjyq gazetarët që kanë paditur punëdhënësit e tyre, raportojnë se nga eksperiencia e tyre që nga momenti i dorëzimit të padisë, deri në përfundimin e shkallës së parë të gjykimit, kalon të paktën një vit. Kjo kohëzgjatje varion nga viti në vit, por edhe nga rrethi gjyqësor, gjyqtari, apo rasti gjyqësor. Prandaj koha mesatare e një procesi gjyqësor për marrëdhëniet e punës raportohet të jetë nga 6 muaj (178) ditë²⁸ në gati dy vite (677 ditë)²⁹. E megjithëse kjo është një kohë shpesh është më e shkurtër se proceset e tjera gjyqësore, shumë prej gazetarëve të intervistuar (44%) e rendisin **kohëzgjatjen e procesit gjyqësor** si një prej faktorëve kryesorë që i pengon ta padisin gjyqësisht punëdhënësin.

Është edhe pak sorollatje, se të marrësh një dokument të thjeshtë në gjykatë të shkon tre muaj... Minimalisht një vit do kërkonte një vit zvarritje, duke parë si shtyhen gjyqet.

(gazetare e re, portal)

Për ta çuar më tej çështjen në gjykatë, dua të them që idea se procesi gjyqësor do marrë vite, na step shumë. Ndoshta një institucion që do të na ndihmonte që të mos ishim vetëm, do ishte shumë mirë, sepse unë e di që nuk do kem mundësi ta ndjek çështjen vetëm. Po të kishim edhe ne një institucion juridik që na mbron do ishim më të sigurtë për ta kërkuar të drejtën në gjykatë.

(gazetar me përvojë, portal)

28 OSBE, Drejt Drejtësisë. *Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore*. Tiranë: OSBE, 2013

29 Qendra InfoCIP. *Marrëdhëniet e punës dhe mbrojtja në gjykatë*. Tiranë: InfoCIP, 2019; “Gjykata e Hapur”. Qendra Info CIP, aksesuar në 15 Shkurt 2020.

*Pengesa e dytë është **kostoja financiare e një procesi gjyqësor.*** Kostoja e një gjyqi varion në varësi të shpërblimit të kërkuar, të zyrës avokatore, dhe të shpenzimeve gjyqësore të kërkuara (për shembull. ekspertiza). Megjithatë, mesatarisht shpenzimet për shkallën e parë gjyqësore variojnë midis 100 mijë dhe në 200 mijë lekë³⁰. Këtu përfshihen tarifat gjyqësore dhe njoftimet, pagesa për avokatin, përgatitja dhe noterizimi i dokumentacionit, si dhe pagesa për ekspertizën³¹. Megjithatë aktualisht Ligji Nr. 98/2017 datë 02/11.2017, Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë është në fuqi që prej qershorit 2018, ai ende nuk ka filluar të zbatohet dhe aktualisht tarifat e aplikuara janë ende ato të parashikuara nga Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave nr.33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë e noterisë”, i cili në Shtojcën nr.1, gërma e) përcakton se tarifa gjyqësore për marrëdhëniet e punës është 0 lekë. Ndërkohë gazetarët vazhdojnë të paguajnë tarifë gjyqësore, që përbën një pengesë për gazetarët që i drejtohen gjykatës.

Kjo shumë financiare bëhet pengesë për ata punonjës të medias (si gazetarë apo operatorë), të cilët kanë paga minimale që variojnë nga 25 mijë deri në 35 mijë lekë. Nga njëra anë shpenzimet gjyqësore janë të tilla që nuk përballohen dot nga të ardhurat e tyre (kërkohen mbi 5 paga mujore). Nga ana tjetër, shpërblimi i kërkuar, që mund të jetë 3 apo 6 paga mujore, është aq i vogël sa nuk i justifikon shpenzimet e gjyqit.

[Ndihma ligjore falas] diferencën e bën tek ato lloj gazetarësh që kanë patur paga qesharake... që nuk e kanë peshën financiare për ta përballuar pagesën e një avokati,

30 Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë, *Udhëzim i përbashkët Nr.33*, datë 29.12.2014

31 Ministria e Drejtësisë, *Tarifat për veprimet dhe shërbimet që kryhen nga administrata gjyqësore.*

shpenzimet gjyqesore, taksa etj... Në rastin e një gazetari të fuqishëm me një imazh, ai nuk vjen për të marrë konsulencë ligjore falas, por shkon tek studio të njohura.... Nuk ka nevojë [thotë emrin e një gazetari të njohur] për një milionë lekë të vjetra ndihmë.

(avokat, klinikë që ofron ndihmë ligjore falas)

Në këto kushte, shërbimi i ndihmës ligjore falas do të ofronte një përfitim të dyfishtë për gazetarët, pasi përveçse do t'iu kursente atyre shpenzimet e nevojshme financiare, do t'iu kursente edhe kohën e nevojshme për të ndjekur një proces gjyqësor, kohë të cilën gazetarët mund ta përdorin për të vazhduar punën, apo për të kërkuar një punë të re.

I mëshoj asistencës ligjore falas se kam ngelur rrugëve, sflita familjen time. Nëse do më ndodhë sërish, do mendohem mirë se ka qenë një histori shumë e vështirë.

(kryeredaktor, palë paditëse në një gjyq me punëdhënësin)

Arsyeja e tretë institucionale që i frenon punonjësit e medias të ndjekin rrugën gjyqësore është **mungesa e dokumentacionit të nevojshëm** për të provuar shkeljen e të drejtave të punëtorëve nga ana e punëdhënësit³², duke filluar me mungesën e kontratave të punës.

Mungesa e kontratës së punës nuk e pengon gjykatën që të prezumojë ekzistencën e marrëdhënies së punës, në kuptimin e Nenit 12 të Kodit të Punës. Dhe në shumë raste, gjykata ka vepruar pikërisht kështu, edhe pse gazetarët nuk kanë patur një kontratë të shkruar me punëdhënësin. E megjithatë, mungesa e kontratës ka një efekt dekurajues, pasi shumë gazetarë besojnë se pa kontratë ata nuk mund t'i drejtohen dot gjykatës. Në këtë pikë, më shumë se sa realiteti objektiv, është

32 Rama, Artan. “5 gazetarët e shkarkuar, asnjë privilegj nga fronti mediatik”. *Faxweb*, Janar 19, 2017.

informacioni dhe perceptimi i gazetarëve për rëndësinë e kontratës që e bën mungesën e saj një pengesë për adresimin e gjykatës nga ana e gazetarëve.

Në qoftë se ke një kontratë, e ke gojën e hapur. Pra nëse s'ke, je i pasigurt, sepse s'ke me çfarë ta vërtetosh [...] që unë punoj aty.

(gazetar, portal)

Ky studim, ashtu si edhe studime të mëparshme³³, ka evidentuar se shumë gazetarë punojnë pa një kontratë pune, çka e bën realisht të vështirë të provohet marrëdhënia e punës në një proces gjyqësor.

Unë kam kontakte me shumë gazetarë të portaleve online, dhe në shumë raste nuk kanë kontrata. Miqtë të mi të afërt, sidomos në 3 muajt e parë, kanë punuar pa kontrata.

*(gazetare e re,
media audiovizive)*

Mirëpo, ndërkohë që nga burime të ndryshme raportohet se shumë gazetarë punojnë në mënyrë informale, pa kontratë apo me kontrata që nuk tregojnë pagesën e plotë mujore, Inspektorati i Punës raporton një situatë krejt tjetër.

Sipas ISHPSHSH nga 47 inspektime në të gjithë Shqipërinë, në vitin 2019 janë evidentuar vetëm 4 punonjës pa kontratë, por që mbas marrjes së masave edhe marrëdhënia me ata punonjës u formalizua, duke e çuar kështu në 0 numrin e punonjësve informal në media³⁴.

33 Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, *Tregu i punës në media*. Tiranë: IDRA, 2019

34 Shkresë përgjigje Nr 249/1 drejtuar Komitetit Shqiptar të Helsinkit, datë 10.02.2020, nga Arben Seferi, Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Shqipëria aderon në Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) me Nr.81 për “Inspektimin në punë, në tregti, dhe në industri”, ratifikuar me ligjin 8185 datë 23.01.1997. Kjo konventë parashikon disa standarde, të cilat nuk respektohen në kushtet e Shqipërisë. Një nga këto standarde parashikohet në Nenin 12 të konventës, ku parashikohet se inspektorët e punës hyjnë lirisht në vendet e punës që i nënshtrohen inspektimit dhe të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar respektimin e të drejtave të punëtorëve. Mirëpo, siç u diskutua në fillim të këtij kapitulli, inspektorët e punës në vend, shpesh janë nën presion për të mos hyrë në mjediset e medias. Dhe në raste të tjera, shkojnë, por pa arritur të kryejnë punën e tyre lirisht, duke mos arritur të raportojnë dot shkeljet e punëdhënësit. Raporti ISHPSHSH i përmendur më sipër, ku pretendohet se ka 0 punonjës të medias pa kontratë, është tregues i këtij kufizimi. Për pasojë, kur gazetari kërkon të padisë punëdhënësin, e ka të vështirë të provojë shkeljen e Kodit të Punës apo të legjislacionit tatimor (si për shembull: punët jashtë orarit, mungesa e pushimeve të paguara, apo pagesa jo e plotë e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore), sepse pronari i medias mund të paraqesë si provë raportet e inspektorateve, të cilat pasqyrojnë një realitet krejt tjetër.

Fig. 10. Situata e informaliteti në sektorin e mediave në Shqipëri
Burimi: ISHPSHSH, 2020

BERAT	
2 punëmarres të evidentuar	2 punëmarres me kontratë pune individuale
↓	
DIBER	
0 punëmarres të evidentuar	0 punëmarres me kontratë pune individuale
↓	
DURRES	
6 punëmarres të evidentuar	6 punëmarres me kontratë pune individuale
↓	
ELBASAN	
55 punëmarres të evidentuar	55 punëmarres me kontratë pune individuale
↓	
FIER	
11 punëmarres të evidentuar	11 punëmarres me kontratë pune individuale
↓	
GJIROKASTER	
48 punëmarres të evidentuar	48 punëmarres me kontratë pune individuale
↓	
KORÇE	
8 punëmarres të evidentuar	8 punëmarres me kontratë pune individuale
↓	
KUKES	
15 punëmarres të evidentuar	15 punëmarres me kontratë pune individuale
↓	
LEZHE	
0 punëmarres të evidentuar	0 punëmarres me kontratë pune individuale
↓	
SHKODER	
36 punëmarres të evidentuar	35 punëmarres me kontratë pune individuale
↓	
TIRANE	
224 punëmarres të evidentuar	220 punëmarres me kontratë pune individuale
↓	
VLORE	
47 punëmarres të evidentuar	47 punëmarres me kontratë pune individuale

Duke konsideruar këtu edhe mungesën e bashkëpunimit nga ana e kolegëve, të cilët sipas raportimeve shpesh refuzojnë të dëshmojnë në gjyq, raportet e inspektimit marrin një rol shumë të rëndësishëm në procesin gjyqësor. Dhe kur ato nuk pasqyrojnë realitetin, ato kthehen në një pengesë për vendosjen e drejtësisë.

Nuk ka qenë e lehtë në çdo proces gjyqësor që të krijohet një hapësirë e manipulimit të situatave ose dhe proceseve të padrejta. Mes tyre ka patur dhe vendime të padrejta, sepse kërkojnë fakte, dhe kur gazetari bën padi i bie barra e provës për ta faktuar padrejtësinë dhe veprën e padrejtë që i ka ndodhur.

(gazetare, palë paditëse në një gjyq me punëdhënësin)

Mungon kontrolli nuk ka nga inspektorati i punës, apo nga organe të tjera tatimore, të cilat duhet ta kontrollnin këtë proces. Pra nis këtu.... Nuk është se i vë fajin gjyqësorit në këtë pikë sesa organeve shtetërore që nuk gjenerojnë mjaftueshëm prova.

(avokat, klinikë që ofron ndihmë ligjore falas)

Kjo marrëdhënie simbiotike mes inspektorateve dhe pronarëve të medias, e përshkruar në mënyrë të detajuar në fillim të këtij kapitulli, është përmbledhur qartë nga një gazetar i ri: “prandaj ai [inspektori] thotë ‘mos e ngacmo! Unë s’i shkoj, ai s’më vjen’”.

2.3.c Mjedisi kulturor dhe psikologjia individuale (individi)

Eliminimi i pengesave institucione të shpjeguara më sipër, nuk do të garantonte automakisht lirinë e gazetarit për të rifituar të drejtat e tij në rrugë gjyqësore. Në fakt, megjithë rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit ligjor falas, vetëm 18% e gazetarëve të anketuar shprehen se nëse procesi gjyqësor do ishte falas, ata do ta kishin hedhur në gjyq punëdhënësin, edhe sikur ai të shkelte të drejtat e tyre.

Prandaj, pasi diskutuam pengesat që vijnë nga shoqëria dhe nga shteti, le të thellohem tek pengesat që lidhen me individin, si pasojë e gjendjes psikologjike (cognitive) apo brendësimit të disa normave që lidhen me mjedisin kulturor. Kjo pjesë është e ndarë nga faktorët social e diskutuar më sipër, pasi brendësimi i normave kulturore është çështje individuale, dhe jo të gjithë individët përgjigjen njësoj. Për shembull, megjithëse tolerimi i abuzimit mund të jetë pjesë e kulturës së punës, gazetari zgjedh ta pranojë ose ta sfidojë atë gjyqësisht.

Pengesa e parë në këtë kategori është **mungesa e informacionit nga ana e punonjësve të medias lidhur me të drejtat e punës**. Të dhënat e studimit tregojnë se pjesa më e madhe e gazetarëve, dhe veçanërisht gazetarët e rinj, janë të painformuar ose të informuar pjesërisht, për të drejtat që atyre iu garantohen nga Kodi i Punës. Gjysma e gazetarëve të anketuar (50%) deklarojnë se nuk kanë patur mundësi të këshillohen me një avokat për kontratën e punës.

Paradoksi i madh është se njerëzit që duhet të jenë më të informuar për të drejtat e punës, gazetarët, janë në fakt të painformuar për ligjin, për të drejtat e tyre, e kështu me rradhë.

(gazetar me përvojë, media audiovizive)

Informacioni mbi ligjin është i rëndësishëm, pasi një gazetar nuk mund të padisë në gjykatë punëdhënësin për një shkelje, për të cilën ai nuk e njeh si shkelje të ligjit. Megjithatë, në shumë raste, është pikërisht besimi që të drejtat do të shkelen gjithësesi, çka i demotivon gazetarët për t'u informuar më tepër mbi legjislacionin e punës.

Pyetje: *A i njohin gazetarët të drejtat e tyre të punës? Sa të informuar janë?*

Përgjigje: *Në përgjithësi jo. Edhe kontratën që e nënshkruajnë, pyesin vetëm “ku ta firmos”, kaq. E firmosin pa lexuar fare.*

(gazetare e re, portal)

Unë vetë e kam nisur me internship dhe më është dhënë kontrata dhe thjesht e kam firmosur. Mendoj që disi jemi të informuar, por në përgjithësi jemi të dekurajuar se mendojmë që gjithësesi do na shkelen të drejtat, kështu që kot që ta lexoj.

(gazetare e re, media audiovizive)

*Një faktor tjetër frenues është **marrëdhënia sociale mes gazetarëve dhe punëdhënësve** të tyre, si dhe **stigma e procesit gjyqësor në shoqëri**. Siç u diskutua edhe më sipër, tregu i punës në fushën e medias është i tillë që punëdhënësi e trajton punësimin si “nder” personal që i ka bërë punëdhënësit. Për pasojë, shumë gazetarë, kryesisht të rinj, ndiejnë detyrim moral që ta shfaqin mirënjohjen e tyre përmes nënshtrimit, apo tolerimit të shkeljeve që punëdhënësi mund të bëjë. Një mendësi e tillë e shton edhe më tepër barrën psikologjike të hedhjes në gjyq të punëdhënësit, edhe kur ai shkel haptazi të drejtat e garantuara nga legjislacioni i punës.*

Nëse pronari të vonon rrogën do ta hidhje në gjyq?

Pyetje e sikletshme, por në qoftë se dikush që të ka ndihmuar shumë dhe ndoshta do kishte ndonjë vonesë, mund të ishte e pranueshme, ndoshta nderi lahet me nder sot në Shqipëri.... Nuk e di nëse do isha i aftë ta bëja. Për momentin ndihesh si borxhli, dikush të dha, duhet t'i japësh. Nëse kjo vonesa e rrogës është diçka që duhet t'i japësh. Është më shumë si çështje karakteri që nuk jam mosmirënjohës dhe lidhet me mirënjohjen.

(gazetar i ri, media audiovizive)

Gjithashtu, duke e parë gjyqin si një proces shumë të rëndë nga pikëpamja psikologjike, shumë gazetarë, nisur nga arsye emocionale, zgjedhin që ta shmangin rrugën gjyqësore si një formë e rifitimit të drejtave të tyre.

*E thashë edhe më parë, që është pengesa emocionale që të
hedhësh në gjyq shefin, me të cilin ke marrëdhënie miqësore.*

(gazetare e re, portal)

Së treti, tendenca e lartë për të emigruar mund të frenojë gazetarët që të nisin një proces gjyqësor. Në fakt, 15% e gazetarëve të intervistuar shprehen se planet për emigrim në të ardhmen e afërt i pengojnë që të hedhin në gjyq punëdhënësin. Duhet theksuar se shpesh këto janë thjesht pritshmëri dëshirore të gazetarëve, dhe jo domosdoshmërisht plane konkrete për emigrim.

Shoqëria shqiptare karakterizohet nga një dëshirë e lartë emigratore, ku çdo vit rreth 360 mijë shqiptarë aplikojnë për llotarinë amerikane³⁵, një pjesë e të cilëve janë gazetarë. Nga njëra anë këto dëshira apo plane, mund të frenojnë gazetarët për të nisur një proces gjyqësor ndaj punëdhënësit, pasi mendojnë që procesi mund të zgjasë përtej kohës kur ata planifikojnë të jenë fizikisht në Shqipëri. Nga ana tjetër, ato mund të kenë një efekt psikologjik ku shumë gazetarë ta trajtojnë *status quo*-në si një problem kalimtar, për të cilin nuk ia vlen të angazhohesh për ta zgjidhur.

*Sot është më keq, sepse kanë qenë njerëzit më idealistë,
ndoshta kemi qenë dhe ne që shpresonim që një ditë do
bëhej më mirë, por nuk e themi më këtë. Unë realisht
mendoj si do iki nga Shqipëria. Se nuk ja vlen të jesh gazetar
në Shqipëri edhe pse duket sikur ka punë. S'e di si do jetë
e ardhmja e gazetarisë. Pronarëve nuk u intereson të kenë
një gazetar të mirë, atyre thjesht u duhet një papagall ose
mekanik të lexojë ato fletët e tyre. Dhe nuk do të doja që
im bir të ishte i tillë. Unë do të doja të kisha një profesion
tjetër që mund të punoja jashtë Shqipërisë. Këtë që kam*

35 “367’231 shqiptarë kanë aplikuar këtë vit për llotarinë amerikane”. *Exit.al*, Gusht 27, 2018

s'punoj dot asgjëkundi. Tani është shumë vonë.

(gazetare, media vizive)

*Së katërti, është kultura mbizotëruese e **tolerimit të shkeljeve** në tregun e medias. Kjo kulturë e tolerimit të shkeljeve ka në themel të saj pranimin e një marrëdhënieje me distancë të lartë hierarkie, ku si ai që nënshtrohet, ashtu edhe ai që komandon, bien dakord që ky është lloji i marrëdhënies që duhet të kenë.*

Une Për shembull nuk e kam lirshmërinë të flas për problemet e punës me kryeredaktorin, por i shprehim këto probleme mes gazetarëve. Nuk e di nëse kryeredaktori do na mirëkuptojë për këto probleme, por unë vetë hezitoj të ankojem tek ai. Nuk e di nga e ka gjenezën ky hezitimi që kemi ne gazetarët, të cilën e kam vënë re edhe në mediat e tjera ku kam punuar.

(gazetare e re, media audiovizive)

Unë mendoj që gazetarët në Shqipëri shpesh i qajnë hallin pronarit, si mënyrë për të justifikuar nënshttrimin e tyre. Edhe thonë “hë se edhe kryeredaktori nuk i ka kushtet e mira. Hë se edhe kryeredaktori vuan”. Ka një hezitim të jashtëzakonshëm për të pyetur për rrogën. Mua vetë kur m'u rinovua kontrata hezitova për një kohë të gjatë të pyesja për rrogën. Kolegia ime nuk e pyeti fare, ndërsa unë mora guximin pas tre ditësh dhe pyeta kryeredaktorin për rrogën. Ishte një situatë e vështirë ku nuk u pamë në sy të dyja palët.

(gazetare e re, portal)

Me fjalë të tjera, tolerimi i shkeljes është e përhapur në të dyja palët, si tek punëdhënësit ashtu edhe tek gazetarët. Nga njëra anë punëdhënësit preferojnë të marrin gazetarë, të cilët nuk ngrenë zërin për të drejtat e tyre të punës. Nga ana tjetër, vetë gazetarët e kanë pranuar shkeljen e të drejtave të punës, si diçka e zakonshme.

Pritshmëria është që ata nuk duan një njeri kryeneç, por tolerant ndaj shtypjes. Këtë ta them jo vetëm në fushën e gazetarisë... Nuk duan njerëz të tillë...Edhe po ndërroi media e njëjta marrëdhënie, të njëjtin ambient do gjejë...

(avokat, përfaqësues i gazetarëve)

Një pjesë e gazetarëve i tolerojnë shkeljet, jo se bien dakord, por se dorëzohen pasi e shohin veten të pafuqishëm për të ndryshuar realitetin. Pjesa tjetër i sheh shkeljet si diçka normale dhe të pranueshme për llojin e punës, dhe për pasojë nuk kanë motivim për të kërkuar një marrëdhënie të ndryshme.

Asnjëherë nuk do ta respektojnë punëdhënësit Kodin e Punës, sepse media është biznes privat dhe për pasojë shfrytëzimi është parim. As gazetarët nuk e kërkojnë

(Shoqatë e gazetarëve)

Po ta shohësh kontratën e punës sime është sikur punon te CNN. Por gazetaria kjo është. Nuk ka orare gazetaria. Doli lajmi, do shkosh. Parimi kryesor është që nuk ka orar, pastaj vijnë këto gjërat e tjera.

(gazetar me përvojë, media audiovizive)

Vonesa e rrogës është e zakonshme. Është si puna e dritave, që po nuk na ikën dritat na bën përshtypje. Një javë, dy javë vonesë rroge, s'është se bëjnë ndonjë gjë. Me çfarë kam parë, disa vite më parë ka qënë më keq, por tani është përmiresuar situata.

(gazetar i ri, portal)

Kjo kulturë e tolerimit të abuzimit, shihet në fakt e shtrirë edhe në aspekte shumë delikate, siç është ngacmimi seksual në ambientet e punës. Siç është diskutuar edhe më sipër, është vënë re gjatë gjatë intervistave në grup si dhe intervistave individuale, që disa gazetarë

gra dhe vajza, i pranojnë si normale fenomene të tilla në vendin e punës.

Vajzat dhe gratë janë po aq fajtore sa ata që i ngacmojnë. Është kaq e rrallë sa nuk të detyron askush. Ka raste kur ke pronar beqar dhe ti je beqare vetë, kështu që normal që ai do ta tentojë.

(gazetare me përvojë, media audiovizive)

Përse shefi ngacmon vetëm njërën dhe jo të gjitha? Ndoshta aty ka diçka... një provokim. Ndoshta ka të bëjë me veshjen në punë. Se një shef ka gjithë ato vajza në punë, përse ngacmon vetëm njërën?

(gazetar i ri, portal)

Sigurisht që ka shumë gazetarë të rinj dhe të vjetër, të cilët refuzojnë ta pranojnë si diçka normale shkeljen e të drejtave të tyre të punës, por ka një numër të konsiderueshëm që i pranojnë shkeljet si pjesë normale të punës. Këta të fundit janë më pak të prirur për ta paditur punëdhënësin e tyre në gjykatë. Në këtë pikë, shqetësimi është për krijimin e një rrethi vicioz ku sa më pak vetë t'i drejtohen gjykatës, aq më të shpeshta do të jenë rastet ku shkeljet nuk ndëshkohen, dhe aq më e pranishme do jetë tendenca për t'i trajtuar ato si pjesë e punës. Ky risk është sidomos më i madh për gazetarët e rinj që gjejnë në media një klimë të tillë të abuzimit me të drejtat e tyre dhe e pranojnë atë si diçka të pandryshueshme.

Të rinjtë po i presim në një mjedis shumë pesimist. Në vend që t'i mësojmë me idenë që duhet të kërkonin të drejtat tuaja, që t'u afrohem vëndeve më të zhvilluara, i presim në një mjedis të zymtë, [ku iu themi] duhet të ulni kokën se po të duan ju heqin [nga puna].

(redaktore, media audiovizive)

Së fundmi, pasi gazetari i ka kapërcyer të gjitha pengesat e përshkruara më sipër, ai ndeshet edhe me pengesën e fundit që është **besimi që gjykata** do japë një vendim të favor të tij. Ka një mungesë të përgjithshme besimi tek paanshmëria e gjykatave, ku gati gjysma e gazetarëve të anketuar (45%) shprehen se nëse padisin punëdhënësin e tyre, ai do ta fitojë gjyqin edhe nëse provat janë në anën e gazetarëve.

Pyetje: *Pra ju nuk keni besim tek drejtësia?*

[disa vetë, pjesëmarrës në fokus grup, qeshin]

Përgjigje: *(duke qeshur) Kur drejtësia liroi dje X si do kemi besim ne?*

Pyetje: *Ke besim po ta çoje në gjykatë që do të zgjidhej?*

Përgjigje: *Jo, sepse po e shoh përditë gjyqësorin dhe shoh që s'po zgjidhen çështje me rëndësi dhe jo më...*

(Gazetar i ri, media audiovizive)

Në këtë pikë, ne nuk kemi patur mundësi për të vërtetuar paanshmërinë faktike të gjykatave. Megjithatë kjo ka pak rëndësi, për sa kohë është perceptimi mbi gjykatat, dhe jo domosdoshmërisht fakti, ai që i inkurajon apo dekurajon gazetarët që të kërkojnë rivendosjen e të drejtave të tyre përmes një procesi gjyqësor.

Gjykatat mund të japin vendime në favor të gazetarëve, siç në fakt ka ndodhur në pjesën më të madhe të rasteve, por nëse gazetarët besojnë se vendimi do jetë në favor të pronarit të medias, ata do të hezitojnë ta çojnë çështjen në gjykatë. Këtu jemi përpara një situatë të *profecisë vetëpërmbythëse*³⁶ku mungesa e besimit, i bën gazetarët të mos i

36 Merton, Robert K. "The Self-Fulfilling Prophecy." *The Antioch Review* 8, no.2 (1948): 193-210. Accessed January 10, 2020. Doi:10.2307/4609267.

drejtohen gjykatës, dhe si pasojë të mos ketë raste suksesi të cilave ata mund tu referohen.

Kjo mund të shpjegojë përse numri i padive ndaj punëdhënësve në media raportohet të jetë 68 në total për gjithë vitin 2019, ndërkohë që në vetëm një muaj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë regjistrohen rreth 600 padi ndaj punëdhënësve të tjerë³⁷.

37 Gjykata e Tiranës, Faqja zyrtare e internetit, aksesuar në 10 Shkurt 2020

KAPITULLI 3



Rekomandime

Siç është diskutuar edhe më sipër, shkelja e të drejtave të punës së gazetarëve, vjen më pak nga mungesa e legjislacionit dhe më shumë nga mos respektimi i tij. Në kushtet e një shteti ligjor funksional, është pikërisht ekzekutivi ai që garanton zbatimin e ligjit. Për pasojë, të drejtat e punës, të parashikuara nga ligjvënësi, duhet të garantoreshin nga inspektoratet që janë në varësi të Ekzekutivit, si Inspektorati i Punës (ISHPSHSH) dhe Inspektorati tatimor (DPT), të cilët janë në varësi të Ministrisë së Financave. Mirëpo, kjo bëhet e pamundur në kushtet kur media është në një marrëdhënie simbiotike me shtetin nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të tjera ekonomike përveç medias, ku korrupsioni i zyrtarëve publik është i lartë³⁸, dhe kur institucionet janë të dobëta për të vepruar të pavarura nga vullneti i drejtuesit të tyre. Siç u diskutua edhe më sipër, mediat kanë aftësinë të kërcënojnë zyrtarët që drejtojnë inspektoratet, dhe këta të fundit kanë kapacitetin të paralizojnë punën e inspektorateve. Për pasojë, gazetari shpesh gjendet i pambrojtur përballë pronarit të medias.

Në këtë pikë, kur pala e tretë që duhet të garantojë ligjin nuk e kryen punën e saj, e vetmja zgjidhje mbetet barazia mes palëve. Në fakt, rregullat marrin kuptim mes palëve të barabarta, të cilat bashkëveprojnë me vullnet të lirë, dhe asnjëra nga palët nuk mund ta detyrojë palën tjetër të veprojë, përveçse si shprehje e interesit reciprok.

38 Transparency International, *Corruption Perception Index*. Berlin: Transparency International, 2019.

Mirëpo, siç u diskutua edhe më sipër, marrëdhënia mes drejtuesve të medias dhe gazetarëve është thellësisht e pabarabartë. Nga njëra anë, kemi drejtues televizioneesh që janë shumë të fuqishëm ekonomikisht dhe kanë ndërtuar një profil medieje që nuk e ka të domosdoshme punësimin e gazetarëve profesionistë. Nga ana tjetër, kemi gazetarë që janë shumë të dobët ekonomikisht, dhe operojnë në një treg të mbyllur, i cili përveçse nuk ka kërkesë të lartë për shërbimet e tyre, ka një mbingarkesë oferte. Kjo ndodh, sepse shpesh shërbimet e kërkuara nga pronarët e medias (si Për shembull përgatitja e artikujve shantazhues) mund t'i ofrojë një pjesë e madhe njerëzish të patrajnuar profesionalisht.

Në këto kushte, rekomandimet tona sugjerojnë ndërhyrje të vështira, pasi situata është e tillë që kërkon një reformim të thellë dhe të plotë. Eksperienca e viteve të fundit ka treguar se ndërhyrjet e pjesshme nuk kanë dhënë rezultatet e dëshiruara, pasi në thelb nuk kanë arritur të përmirësojnë pozitën e gazetarit përballë pronarit të medias.

Prandaj rekomandohet si më poshtë:

Ndërhyrje politike:

- 1. Promovimi i organizatave që ofrojnë shërbim ligjor falas për punonjësit e medias.** Siç është diskutuar edhe më sipër, shërbimi ligjor falas i ofron gazetarëve një përfitim të dyanshëm: iu heq barrën financiare, dhe iu kursen kohën e nevojshme për të ndjekur një proces gjyqësor. Në këtë pikë, fuqizimi i sindikatave të gazetarëve dhe mbështetja financiare dhe promovimi i organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë këto shërbime për gazetarët do t'i ndihmonte ata në realizimin e të drejtave të tyre gjyqësisht.
- 2. Fuqizimi i medias publike.** Taksapaguesit shqiptarë paguajnë çdo vit rreth 9 milion euro tarifë për aparat televiziv, e cila

shkon për Radio Televizionin Shqiptar (RTSH), dhe 11 milion euro jepen nga buxheti i shtetit. Një menaxhim më eficient i fondeve, një strukturë më transparente rekrutimi dhe një rishikim i pagave të gazetarëve, do ta bënte këtë media më konkurese në tregun mediatik, duke i dhënë gazetarëve një alternativë konkurruese. Gjithashtu, duhet riparë struktura e administrimit dhe drejtimit të transmetuesit publik, në mënyrë që të shmanget përqëndrimi i pushtetit në pak vetë, si dhe të sigurohet kontrolli efektiv financiar dhe administrativ. Përmirësimi i pozitave të RTSH-së në treg do të kontribuonte në drejtim të rritjes së standarteve nga mediat e tyre, veçanërisht në raport me trajtimin e gazetarëve.

- 3. Promovimi i medias lokale komunitare.** Shteti duhet të garantojë ekzistencën e mediave lokale duke krijuar një fond për mediat lokale komunitare, si gazeta lokale elektronike. Për krijimin e këtyre mediave lokale komunitare, mund të merret shembulli i Britanisë, ku prej disa kohësh aplikohen forma të tilla pronësie mbi median. Ato shërbejnë për krijuar një hapësirë të mbrojtur si për publikun ashtu edhe për gazetarët.

Ndërhyrje ligjore:

- 1. Liberalizimi i tregut të medias dhe lufta ndaj përqëndrimit** të pronësisë në media duke rikthyer kuotën tavan për aksionet në mediat audiovizive, sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe OSBE-së. Ligji për mediat audiovizive në RSH duhet të parashikojë kufizime për aksionet që një subjekt mund të ketë mbi një media. Gjithashtu ligji duhet të parashikojë një kuotë aksionesh të mbrojtura, e cila u jepet punëtorëve, duke i bërë ata bashkëpronarë në mediat ku punojnë. Këto ndryshime duhen bërë duke ndjekur interpretimin që Gjykata Kushtetuese i ka bërë neneve 11, 22 dhe 23 të Kushtetutës në Vendimin nr.56,

datë datë 20.07.2016. Gjithashtu, ka ardhur koha që referuar edhe rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë, vetë ligjvënësi nëpërmjet parashikimeve ligjore dhe vetë Gjykata Kushtetuese nëpërmjet interpretimit kushtetues (nëse do të jetë rasti) të rivlerësojnë qëndrimin e tyre në lidhje me liberalizimin e tregut të medias, në funksion të garantimit të lirisë së shprehjes dhe rritjes së cilësisë së medias, duke shmangur konfliktin e interesave të pronarëve.

2. Rekomandohen ndryshime në Kodin Penal në lidhje me veprat penale të kryera ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias për shkak të detyrës, për të parashikuar mbrojtje të posaçme penale ndaj tyre duke rritur sigurinë e tyre në vendin e punës.

3. Mbrojtja e lirisë së sindikatave të gazetarëve.

Rekomandohet ndryshimi i ligjit 97/2013, për mediat audiovizive, për të përfshirë aplikimin e masave të parashikuara në nenin 132, pika 1, për punëdhënësit që kufizojnë të drejtat sindikale të punonjësve të medias, dhe që veçanërisht shkelin Nenin 184 të Kodit të Punës; apo që nuk respektojnë detyrimet që iu lindin për kontratën kolektive të punës, sipas parashikimeve të Kodit të Punës, nenet 159-175, dhe Konventës Nr.154 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Bisedimet Kolektive” (1981), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.8856, datë 07.02.2002. Këto sanksione të rekomanduara, duhet të aplikohen paralelisht me sanksionet e parashikuara në Nenin 202, të Kodit të Punës.

Për institucionet mbikëqyrëse:

1. Në respektim të neni 6 të Konventës Nr.81 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të sigurohet pavarësia e Inspektoriatit të Punës nga ekzekutivi dhe të garantohet pavarësia e

inspektorëve, duke kufizuar pushtetin e drejtuesit të institucionit për shkarkimin e tyre nga puna dhe për të ndikuar inspektimin.

2. Në respektim të Nenit 7 të Konventës Nr.81 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi inspektimin e punës në tregti dhe industri”, inspektorët të trajnohen për specifikat e punës në media dhe evidentimin e shkeljeve të së drejtave të punës. Në respektim të Nenit 9, grupet e kontrollit të përbëhen nga ekspertë të fushave të ndryshme, dhe njohës të problematikave të punës në media, duke përfshirë përfaqësues të sindikatave apo shoqatave të gazetarëve.
3. Inspektorati Qendror duhet të parashikojë një kalendar të kontrolleve periodike dhe të koordinuara të të gjitha mediave, duke përfshirë edhe mediat online. Kjo kërkon që Inspektorati i Punës ta klasifikojë median si një kategori më vete për inspektimin, dhe jo si pjesë e subjekteve “të tjera”. Ndërsa Inspektorati Tatimor ta klasifikojë atë tek kategoritë me risk të lartë. Këto kontrolle duhet të bëhen në respektim të Neneve 16 dhe 17 të Konventës Nr.81 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi inspektimin e punës në tregti dhe industri”, ku parashikohet se kontrollohet duhet të kryhen aq shpesh sa është e nevojshme për të garantuar respektimin e të drejtave të punës.
4. ISHP duhet të kryejë inspektime në lidhje me respektimin e të drejtave të rrjedhura nga Kodi i Punës si gjatë periudhës së provës, ashtu edhe gjatë ekzistencës së marrëdhënies së punës, si dhe pagimin e rregullt të sigurimeve shoqërore e shëndetësore mbi bazën e pagave reale, përfshirë pagimin e orëve jashtë orarit, kryerjen e pagesave në kohë, etj., si dhe kryerjen e inspektimeve tematike e kalendarike në lidhje me kushtet e punës, higjenën dhe respektimin e detyrimeve të rrjedhura nga Kodi i Punës nga ana e punëdhënësit.

5. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të ndërmarrë me nismën e tij dhe në respektim të dispozitave të ligjit Nr.10221 datë 04.02.2010, anketa nëpër media për të evidentuar situatën e diskriminimit në bazë të gjinisë, moshës apo përkatësisë etnike, apo ngacmimet seksuale me bazë gjinore.
6. Në respektim të Nenit 32, të ligjit Nr. 10221, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të ketë një rol pro-aktiv dhe të nisë hetimin administrativ nëpër redaksitë e mediave për të evidentuar rastet e diskriminimit apo abuzimit ndaj gazetarëve gra dhe vajza (diskriminim për shkak të gjinisë), ndaj studentëve të gazetarisë apo gazetarëve të sapodiplomuar (diskriminim për shkak të moshës), etj. Në rast të evidentimit të ngacmimit seksual, Komisioneri duhet t'i referojë çështjet në prokurori, në respektim të dispozitave të Kodit Penal.
7. Krijimi i mekanizmave ligjorë dhe trajnimi i tyre, për trajtimin me shpejtësi dhe përparësi nga ana e policisë i rasteve të denoncimeve të kryera nga gazetarët për kërcënime për shkak të profesionit, duke rritur sigurinë e tyre në punë.

Për Shoqërinë civile:

1. Sindikatat dhe Shoqatat e Gazetarëve, mund të ndjekin modelin e organizimit të unioneve të ngjashme evropiane dhe të vlerësojnë mundësinë që të anëtarësohet në to, për të siguruar mbështetje ndërkombëtare në veprimtarinë e tyre. Gjithashtu duhet të rritet bashkëpunimi me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO-n) si për të mbrojtur të drejtat e punës së gazetarëve, duke punuar për përmirësimin e legjislacionit dhe për të rritur kapacitetet profesionale.
2. Vetë sindikatat e gazetarëve duhet të parashikojnë një fond të veçantë për të mbuluar shpenzimet gjyqësore të anëtarëve të

tyre, qoftë kur ata padisin punëdhënësin, ashtu edhe kur ata paditen nga palë të treta për shkak të punës së tyre.

3. Sindikatat e gazetarëve mund të konsiderojnë mundësinë që të bashkëpunojnë me kompanitë e sigurimeve, në mënyrë që t'u ofrojnë gazetarëve një asistencë ekonomike private, në rastet kur ata humbasin në mënyrë të papritur punën, apo kur janë në proces gjyqësor me punëdhënësin. Një garanci e tillë, do të krijonte më tepër vetëbesim tek gazetarët, duke i bërë ata më të prirur për të ndjekur rrugën gjyqësore në rastet kur iu shkelen të drejtat e punës të parashikuara me ligj.

BIBLIOGRAFIA E STUDIMIT

Asambleja e OKB-së. *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*. 302, nr.2 New York: OKB, 1948 URL: <https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

Departamenti i gazetarisë, Universiteti i Tiranës. *Sondazhi, Ku informohen shqiptarët?*. Publikuar në *Dritare.net*. Aksesuar në Janar 15, 2020. <https://dritare.net/ku-informohen-shqiptaret-mediat-e-shkruar-humbin-poziten-televizioni-akoma-i-forte/>

“Shqiptarët heqin dorë nga televizioni, ja ku informohen më së shumti.” *Gazeta Express*. Qershor 03, 2019. <https://www.gazetaexpress.com/shqiptaret-heqin-dore-nga-televizioni-ja-ku-informohen-me-se-shumti/>

Freedom House, *Freedom in the World*. Washington D.C: Freedom House, 2019. URL: https://freedomhouse.org/sites/default/files/Feb2019_FH_FITW_2019_Report_Forweb-compressed.pdf

Open Society Foundation, *Peizazh i medias online në Shqipëri*. Tiranë: OSFA, 2018 URL: http://www.osfa.al/sites/default/files/peizazh_i_medias_online.pdf

Kabashi, Gëzim. “Kosotot e dixhitalizimit mbyllin televizionet lokale”. *BIRN*, Nëntor 9, 2019 URL: reporter.al/kosotot-e-dixhitalizimit-mbyllin-televizionet-lokale/

Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, *Tregu i punës në media*. Tiranë: IDRA, 2019 URL: <https://idracompany.com/files/AL->

[B-Studimi%20mbi%20hendekun%20e%20aft%C3%ABsive%20n%C3%AB%20media.pdf](#)

Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, *Panorama e medias në Shqipëri*. Tiranë:IDRA, 2019

Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore dhe Citizens Channel, *Duke synuar kushte te drejta pune - Shqyrtim i të ardhmes së gazetarëve të rinj dhe atyre të ardhshëm*. Tiranë: Citizens Channel, 2019 URL: <https://citizens-channel.com/2019/10/23/studim-duke-synuar-kushte-te-drejta-pune-shqyrtim-i-te-ardhmes-se-gazetareve-te-rinj-dhe-atyre-te-ardhshem/>

Seferi Arben (Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore), Shkresë përgjigje Nr 249/1 drejtuar Komitetit Shqiptar të Helsinkit, datë 10.02.2020

Lamallari Besfort (Zv/Ministër i Brendshëm) në emisionin Opinion, Shtator 2018. URL: <https://tvklan.al/alarmi-i-zv-ministrit-platforma-mediatike-paguhen-nga-grupe-kriminale/>

Picari, Mimoza. “Media, gazetarët të ekspozuar përballë informalitetit në punë”. *Voice of America*, Maj 20, 2019. URL: <https://www.zeriamerikes.com/a/4924682.html>

Gjykata Kushtetuese. Vendim nr.56 datë 20.07.2016. URL: http://www.gjk.gov.al/web/NJOFTIM_P_R_MEDI-AN_1191_1.php

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, *Të mbyllësh systë ndaj lajmin: Vetëcensura në median shqiptare*. Tiranë: BIRN, 2015. URL: <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/05/Raport-mbi-vete-censuren-ne-median-shqiptare.pdf>

Vlahutin, Romana (Head of the EU Delegation to Albania). Letter to the speaker of the Parliament. June 19, 2015. URL: <https://www.re->

[porter.al/wp-content/uploads/Vlahutin-per-asitencen-per-p.l-Balla1.pdf](http://reporter.al/wp-content/uploads/Vlahutin-per-asitencen-per-p.l-Balla1.pdf)

Erebara, Gjergj. “OSBE kërkon rikthimin e kufizimit të pronësisë në media”. *Reporter.al*, Shtator 5, 2019. URL:<https://www.reporter.al/osbe-kerkon-rikthimin-e-kufizimit-te-pronesise-ne-media/>

Komisioni Evropian. Raporti për Shqipërinë 2019. Bruksel: Bashkimi Evropian, 2019. URL:<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

Ruci, Ani. “Biznes familiar – Miti i medias pluraliste në Shqipëri”. *Deutsche Welle*, Mars 13, 2018. URL:<https://www.dw.com/sq/biznes-familiar-miti-i-medias-pluraliste-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/a-42952443>

Qendra Respublica. *Padia Kolektive*. Tiranë: Respublica, 2018. URL:<https://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2018/07/Studi-mi-per-padite-kolektive-ok.pdf>

OSBE, *Drejt Drejtësisë. Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore*. Tiranë: OSBE, 2013 URL: <https://www.osce.org/sq/albania/100389?doenload=true>

Qendra InfoCIP. *Marrdhëniet e punës dhe mbrojtja në gjykatë*. Tiranë: InfoCIP, 2019. URL:<http://www.infocip.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Kohezgjatja-e-shqyrtimit-gjyqesor-administrativ-2017-2018-gjykataehapur.pdf>

“Gjykata e Hapur”. Qendra Info CIP, aksesuar në 15 Shkurt 2020. URL:<https://www.gjykataehapur.al/vleresimi-i-kohezgjatjes-gjyqesore-ceshtje-civile-gjykata-e-faktit-tirane-2018-2/>

Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë, *Udhëzim i përbashkët Nr.33*, datë 29.12.2014 URL:http://www.pp.gov.al/web/udh_zim_i_p_rbashk_t_per_tarifat_e_adm_958.pdf

Ministria e Drejtësisë, *Tarifat për veprimet dhe shërbimet që kryhen nga administrate gjyqësore*. URL:https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Tarifat_e_reja.pdf

Ligj Nr. 98/2017 datë 02/11.2017, *Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë*. URL:<https://qbz.gov.al/eli/fz/2017/225/70dc1615-0bab-42f7-a89a-25cb19cf7b15;q=98%2F2017>

Rama, Artan. “5 gazetarët e shkarkuar, asnjë privilegj nga fronti mediatik”. *Faxweb*, Janar 19, 2017. URL:<https://www.faxweb.al/5-gazetar-et-e-shkarkuar-asnje-privilegj-nga-fronti-mediatik/>

“367’231 shqiptarë kanë aplikuar këtë vit për llotarinë amerikane”. *Exit.al*, Gusht 27, 2018 URL:<https://exit.al/2018/08/367231-mije-shqiptare-kane-aplikuar-kete-vit-per-llo-tarine-amerikane/>

Merton, Robert K. “The Self-Fulfilling Prophecy.” *The Antioch Review* 8, no.2 (1948): 193-210. Accessed January 10, 2020. Doi:10.2307/4609267.

Gjykata e Tiranës, aksesuar në 10 Shkurt 2020 URL:<http://www.gjykatatirana.gov.al/>

Transparency International, *Corruption Perception Index*. Berlin: Transparency International, 2019. URL: <https://www.transparency.org/cpi2019>

ANEKSI 1

Instrumentet

R.1 Kodi intervistës	
R.2 Qyteti:	
R.3 Institucioni:	
R.4 Data: ____ / ____ / 2019	R.5 Ora : ____ : ____
R.6 Kohëzgjatja: ____ min.	
R.7 Mosha:	R.8 Gjinia:
a.18–25 b.26–30 c.31–40 d.41–50 e.51–65 f.>65	M F
R.9 Profesioni/roli:	
a. gazetar TV b. Gazetar portal c. redaktor d. kryeredaktor/drejtor informacioni e. Sindikatë/OJF f. pronar medie g. avokat i. punonjës i administratës o. Tjetër__	
R.10 Ekperienca profesionale (vite në punë):	
a. 1-4 vite b.5-15 vite c. mbi 15 vite	
R.11.a Shkollimi maksimal që keni kryer	
a) i mesëm b)i lartë c)Master d) PhD e) tjetër	
R.11.b a. të gjitha diplomat jashtë shtetit b. një/disa diploma jashtë c. asnjë diplome jashtë	

INTERVISTË E THELLUAR

GAZETARË

Le ta nisim me një pyetje të përgjithshme: a jeni të kënaqur me profesionin tuaj?

Çfarë nuk shkon, përse i përket ambientit të punës?

Ka patur momente kur keni menduar ta lini vendin e punës për shkak të kushteve të punës? Po të largoheni fare nga profesioni? Nëse po, sa herë e keni menduar? Cila ka qenë arsyeja që ju ka bërë të qëndroni?

Kur keni lidhur kontratë për herë të parë, jeni konsultuar me një jurist ose avokat? Nëse jo, pse?

A mund të thoni se i njihni mirë të drejtat që ju garantohen nga Kodi i Punës?

A keni shërbyer një periudhë prove? A nënshkruat kontratë kur u morët në periudhë prove? Çfarë ndodhi pas periudhës së provës?

A përshkruhet puna juaj në mënyrë të detajuar në kontratën e punës? A respektohet ajo nga punëdhënësi? Ndodh shpesh që ju të bëni detyra që nuk janë në përshkrimin e punës?

Si mendon, përse nuk e respekton punëdhënësi Kodin e Punës?

Çfarë formimi profesional dhe arsimor ka punëdhënësi juaj?

A flasin gazetarët hapur për këto shkelje të të drejtave? Nëse po, ku

flasin? Cilat janë mediumet dhe instrumentet e ankimit? Nëse jo, përse nuk reagojnë?

A dini raste kur dikush nga komuniteti ka reaguar për këto shkelje? Nëse po, çfarë ka ndodhur më pas?

A jeni në dijeni të ndonjë rasti kur dikush ka reaguar dhe ka fituar të drejtën e vet? Nëse po, përse mendoni se ata kanë patur sukses? Çfarë ka ndikuar në këtë rast?

A ju ka ndodhur juve vetë, apo keni qënë ju dëshmitar i ndonjë rasti ku gazetarëve iu janë shkelur të drejtat nga punëdhënësi, direkt pronari ose dikush prej drejtuesve në hierarkinë e medias?

Si keni vepruar në këtë rast?

Përse nuk keni reaguar? Çfarë ju ka penguar?

Nëse do ishte në dorën tuaj, cilat do ishin dy gjëra që ju do të kishit bërë për të penguar shkeljen që shumë pronarë mediash i bëjnë të drejtave të gazetarëve?

Çfarë mendoni se duhet bërë për t'i bërë gazetarët që të reagojnë publikisht në mbrojtje të të drejtave të tyre?

Si mund të lehtësohet procesi i ankimit gjyqësor për gazetarët ?

Ka ndonjë gjë në lidhje me këtë temë që do të donit ta diskutonim, por nuk iu dha mundësia që ta diskutonim gjatë kësaj interviste?

PYETËSORËT

A- Informacion i përgjithshëm

A1. Vjetërsia në punë:

a. më pak se 5 vjet b. 5 deri në 10 vjet c. Mbi 10 vjet

A2. Qyteti:

A3. Moshë:

a.18–25 b.26–30 c.31–40 d.41–50 e.51–65 f.>65 M F

A4. Gjinia:

A5. Shkollimi:

a. Mesëm b.Lartë c. Master d.Doktoraturë e.Tjetër

A8. Cilët nga pohimet e mëposhtme janë të vërteta (shënoni një kryq)?

Kam studiuar në Evropë dhe/ose SHBA

Kam jetuar dhe punuar në Evropë dhe/ose SHBA

B- Solidariteti

B1. Nëse një pronar medias i vonon rrogat për më shumë se dy muaj, çfarë ka më tepër gjasë që të ndodhë?

- a. Gazetarët do protestojnë brenda zyrave, por lajmi nuk do të dalë
- b. Gazetarët do e bëjnë publik lajmin tek media e tyre ose tek media të tjera

- c. Gazetarët do ta hedhin në gjyq pronarin e medias
- g. Gazetarët nuk do bëjnë asgjë tjetër, por do presin derisa pronari të japë pagesat e vonuara

B2. Nëse ju do të pushoheni padrejtësisht nga puna për shkak të bindjeve tuaja politike, çfarë ka më tepër gjasë që të ndodhë? (Qarko të gjitha që janë të vërteta)

- a. Kolegët e mi gazetarë do të protestojnë tek punëdhënësi
- b. Kolegët e mi gazetarë do të protestojnë publikisht
- c. Shoqatat e gazetarëve do të reagojnë publikisht
- d. Gazetarët e njohur në vend do të denoncojnë këtë padrejtësi
- e. Nuk do të ndodhë asgjë

C- Vështirësitë

Ne nje shkalle nga 1 tek 5, në të cilën 1 = 'gjithmonë e vërtetë' dhe 5 = 'gjithmonë e pavërtetë', për pohimet e mëposhtme

DK / DËA
Gjithmonë e pavërtetë
E pavërtetë
As njëra as tjetra
E vërtetë
Gjithmonë e vërtetë

1	Në median ku unë punoj gratë ndihen të sigurta që shtatzania nuk ndikon negativisht në marrëdhëniet e tyre të punës	1	2	3	4	5	9
2	Në median ku unë punoj të gjithë gazetarët kanë kontratë pune	1	2	3	4	5	9

Ne nje shkalle nga 1 tek 5, në të cilën 1 = ‘gjithmonë e vërtetë dhe 5 = ‘gjithmonë e pavërtetë’, për pohimet e mëposhtme		DK / DËA				
		Gjithmonë e vërtetë	E vërtetë	As njëra as tjetra	E pavërtetë	Gjithmonë e pavërtetë
3	Në median ku unë punoj kontratë të përhershme kanë vetëm gazetarët e preferuar të shefave	1	2	3	4	5 9
4	Në median ku unë punoj nuk punohet asnjëherë më shumë se 40 orë në javë (8 orë/ditë për 5 ditë/javë)	1	2	3	4	5 9
5	Në median ku unë punoj rroga nuk vonohet asnjëherë më shumë se 5 ditë nga koha e përcaktuar në kontratë	1	2	3	4	5 9
6	Sa herë që kam punuar mbas orës 22:00 kam marrë një shtesë page të paktën 50%.	1	2	3	4	5 9
7	Unë kam gjithmonë pushim ditën e diel	1	2	3	4	5 9
8	Unë ndihem i/e fyer nga mënyra se si punëdhënësi më flet, gjuha që përdor apo toni i lartë i zërit	1	2	3	4	5 9
9	Rroga ime paguhet e gjitha në bankë	1	2	3	4	5 9
10	Punëdhënësi im nuk m’i paguan as sigurimet shoqërore,as shëndetësore	1	2	3	4	5 9
11	Në median ku unë punoj ngritja në detyrë bazohet në meritë dhe aftësi	1	2	3	4	5 9

Ne nje shkalle nga 1 tek 5, në të cilën 1 = ‘gjithmonë e vërtetë dhe 5 = ‘gjithmonë e pavërtetë’, për pohimet e mëposhtme		DK / DËA				
		Gjithmonë e pavërtetë				
		E pavërtetë				
		As njëra as tjetra				
		E vërtetë				
		Gjithmonë e vërtetë				
12	Në median ku unë punoj, gazetarët burra paguhen më shumë se sa koleget e tyre gra	1	2	3	4	5 9
13	Unë nuk ndihem nën trynë prej personave të gjinisë tjetër, të cilët janë në pozicion hierarkik mbi mua	1	2	3	4	5 9
14	Pronari i medias ku punoj nuk më ka diktuar asnjëherë përmbajtjen e lajmit apo artikullit që kam publikuar.	1	2	3	4	5 9
15	Unë nuk kam patur mundësi të këshillohesha me një jurist (avokat) për kontratën përpara se ta firmosja	1	2	3	4	5 9
16	Unë njoh raste të gazetarëve që kanë qenë viktimë të ngacmimit seksual në një nga mediat ku unë kam punuar më parë ose punoj aktualisht.	1	2	3	4	5 9
17	Punëdhënësi më ka krijuar mundësinë që unë të marr pjesë vazhdimisht në trajnime dhe programe kualifikimi profesional.	1	2	3	4	5 9
18	Unë si gazetar kam frikë të dalë publikisht kundër linjës editoriale të medias ku punoj	1	2	3	4	5 9

E.1 Nëse krahasoheni me të tjerët në komunitetin tuaj, ku mendoni se qëndron gjendja aktuale financiare e familjes suaj?

Shumë të varfër					Shumë të pasur					
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	DK
										98

D- Pengesat

Në një shkallë nga 1 tek 5, në të cilën 1 = ‘Plotësisht kundër’ dhe 5 = ‘plotësisht dakord’, shprehuni sa dakord apo kundër do të ishe me shprehjet e mëposhteme:		Plotësisht kundër	Kunder	As njëra as tjetra	Dakord	Plotësisht dakord	DK / DËA
1	Unë besoj që nëse një punëdhënës shkel Kodin e Punës, unë mund ta padis atë në gjykatë dhe vendimi do të jetë në favorin tim	1	2	3	4	5	9
2	Nëse unë do të ngre zërin kundër pronarit të medias ku punoj, asnjë nga kolegët nuk do të më mbështesë	1	2	3	4	5	9
3	Nëse unë ankohe m publikisht për pronarin e medias ku punoj, familjarët e mi do të më kritikojnë	1	2	3	4	5	9
4	Unë nuk besoj tek gjykatat, sepse ato janë të korruptuara dhe nëse gazetari hedh në gjyq pronarin e medias vendimi do jetë në favor të pronarit, edhe kur ka prova që ai ka shkelur Kodin e Punës.	1	2	3	4	5	9

5	Nëse unë kam një problem me pronarin e medias ku punoj, unë ndihem i mbrojtur nga shoqatat e gazetarëve	1	2	3	4	5	9
6	Nëse unë kam një problem me pronarin e medias do ishte më e ndershme që ta zgjidh miqësisht dhe jo përmes gjykatës	1	2	3	4	5	9
7	Gratë gazetare e kanë më të vështirë të hedhin në gjyq pronarin e medias ku punojnë	1	2	3	4	5	9
8	Nëse unë hedh në gjyq pronarin e medias ku punoj, rrezikoj të mbetem edhe më keq ekonomikisht	1	2	3	4	5	9
9	Nëse procesi gjyqësor do të ishte falas, unë do ta kisha hedhur në gjyq pronarin e medias ku kam punuar më parë, apo ku punoj tani.	1	2	3	4	5	9
10	Burrat gazetarë e kanë më të vështirë të ankohen publikisht nëse nuk kanë marrë rrogën	1	2	3	4	5	9
11	Unë besoj që po ta padis pronarin e medias, gjykata do vendosë në favorin tim, por proceset gjyqësore zgjasin me vite dhe nuk ja vlen.	1	2	3	4	5	9
12	Nuk ja vlen të ankohesh kundër pronarit të medias, sepse ai i ka të gjitha mundësitë që të hakmerret	1	2	3	4	5	9
13	Do ta kisha hedhur në gjyq pronarin e medias ku punoj, por kam në plan / pres të iki nga qyteti ku punoj (apo nga Shqipëria) në të ardhmen e afërt.	1	2	3	4	5	9

INSTRUMENT PËR FOKUS GRUP

Gazetarë të Medias (print, online dhe audio-vizive)

Situata e përgjithshme e respektimit të të drejtave të punës

- Si ndihen gazetarët me profesionin e tyre?

Ekzamino: Diferencat në përgjigje të dhëna nga gazetarët bazuar në moshë dhe ekspertizë (të rinj vs me përvojë); në gjini (a ka ndryshime mes grave dhe burrave); dhe në llojin e medias (a është situata e ndryshme për gazetarët që punojnë për portalet online?).

- A ndihen ata që të drejtat e punës respektohen nga punëdhënësit e tyre?
- A i njohin të drejtat e garantuara nga Kodi i Punës?

Ekzamino: Cili është lloji i punës që bëjnë në redaksi? Sa orë punojnë? A kanë kontrata pune? A respektohen kontratat? A paguhen orët shtesë, puna në ditë festash, a marrin pushimet vjetore të paguara, a paguhen kur janë sëmurë, a marrin shpërblime? Për gratë, a merren/paguhen lejet e lindjes, paslindjes? A kanë lehtësira në punë pas lindjes sipas parashikimeve të Kodit?

- Nëse jo, përse pronarët i shkelin të drejtat e punës?

Ekzamino: përvec përfitimeve ekonomike, a ka faktorë të tjerë social që ndikojnë në sjelljen abuzive nga ana e pronarëve? Si Për shembull: arroganca, vlerësimi i ulët për gazetarët?

- Cilat janë format e abuzimit? Shpjego mënyrën se si shkelen të drejtat e punës së gazetarëve?
- Shembuj ku ata janë dëshmitarë të rasteve të shkeljes së Kodit të Punës

Arsyet lidhur me mos “raportimin” e shkeljes së të drejtave të punës

- A flasin gazetarët hapur për mos-respektimin e të drejtave të punës?
- Nëse po, ku flasin? Përse?
- A flasin ata në media për këto probleme? Nëse jo, përse?
- A i drejtohen gazetarët gjykatës për të kërkuar respektimin e të drejtave që garantohen nga Kodi i Punës? Nëse jo, përse jo?
- Shembuj që ata njohin të gazetarëve që i janë drejtuar gjykatës

Ekzamino: Nëse nuk kanë dalë deri në këtë moment, ekzamino faktorët e mëposhtëm në pengesat që hasin gazetarët për të denoncuar shkeljen e të drejtave të punës

a- (Arsye) institucionale

- Mungojnë mekanizmat e ankimit gjyqësor, ose nuk janë eficiente
- Mungojnë sindikatat, ose janë të dobëta
- Pengesa financiare për të nisur një proces gjyqësor
- Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore
- Kuadri ligjor i hapësira për abuzim

b- (Arsye) kulturore dhe sociale

- a. Mosnjohja e Kodit të Punës
- b. Mungesat e besimit tek gjykata
- c. Mungesa e besimit tek forca e tyre për tu përballur me pronarin
- d. Mungesa e solidaritetit profesional
- e. Shembujt dekurajues, shembuj të gazetarëve që nuk ia kanë dalë, ose janë ndëshkuar edhe më tepër
- f. Presioni social mbi marrëdhënien e besimit dhe prirjen për të mos e përfshirë shtetin në zgjidhjen e konflikteve
- g. Presioni financiar, nevoja për para dhe pamundësia për të pritur zgjidhjen e problemit



 069 4075732 / 0682023699

 +355(0)4223 3671

 office@ahc.org.al

 Rr. Brigada e VIII, Pallati Tekno Projekt,
Shkalla 2 Apt 10 Kati 6, Tirana, Albania

